



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI POLITEKNIK  
FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE**

**Disertacion**

**Për marrjen e gradës shkencore Doktor**

**TEMA**

**RREGULLIMI FREKUENCË - FUQI GJATË LIDHJES  
NË PARALEL TË SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK  
SHQIPËTAR ME SISTEMET FQINJË**

Përgatitur nga:  
**Msc.Ing. Aldi Muçka**

Udhëheqës Shkencor:  
**Prof.Dr. Gëzim Karapici**

Tiranë, Shtator 2022

# DISERTACION

**I paraqitur nga Msc. Ing. ALDI MUÇKA**

**PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE  
“DOKTOR”**

**Në Inxhinieri Elektrike – drejtimi Elektroenergjetikë**

TEMA

**RREGULLIMI FREKUENCË - FUQI GJATË LIDHJES  
NË PARALEL TË SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK  
SHQIPËTAR ME SISTEMET FQINJË**

Mbrohet më datë \_\_\_/\_\_\_2022 para jurisë, e miratuar nga KKPA e FIE me Vendimin Nr. 11, datë 13.09.2022.

- |  |                          |
|--|--------------------------|
| <b>1. Akad. Asoc. Prof. Dr. RAJMONDA BUHAJLOTI</b> | <b>KRYETARE</b>          |
| <b>2. Prof. Dr. MARIALIS ÇELO</b>                  | <b>ANËTARE (OPONENT)</b> |
| <b>3. Prof. Asc. ASTRIT BARDHI</b>                 | <b>ANËTAR</b>            |
| <b>4. Akad.Prof. Dr. NEKI FRASHËRI</b>             | <b>ANËTAR</b>            |
| <b>5. Prof. Dr. PIRO CIPO</b>                      | <b>ANËTAR (OPONENT)</b>  |

## ***Mirënjohje***

*“Një mik i mirë është ai që të ndihmon gjatë dështimeve dhe të vlerëson gjatë sukseseve” Daug Larson*

*Falënderoj në mënyrë të veçantë udhëheqësin tim në këtë punim Prof.Dr. Gëzim Karapici. I jam mirënjohës për gatishmërinë e tij për të më ndihmuar, për këshillat dhe sugjerimet e vazhdueshme dhe mbështetjen morale për përfundimin me sukses të këtij punimi.*

*Ky punim nuk mund të kryhej me sukses dhe pa të gjithë ata që më ndihmuan dhe më mbështetën në këtë rrugëtim të gjatë por shumë të vlefshëm, ketu dëshiroj të falënderoj përzemërsisht Prof.Dr. Nako Hobdari, Prof.Dr. Rajmonda Buhaljoti, dhe Prof.Dr. Marialis Çelo për këshillat, dashamirësinë dhe ndihmën e tyre të papërtuar. Falënderoj gjithashtu kolegët e Departamentit të Sistemeve Elektrike të Fuqisë për bashkepunimin dhe kontributin e tyre. Një falenderim i veçantë shkon për dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike Prof.Asc. Astrit Bardhi për suportin dhe ndihmën e vazhdueshme.*

*Në veçanti falënderoj familjen time të dashur, bashkëshortën time Keti dhe vogelushen Arba, për durimin, mbështetjen dhe inkurajimin e vazhdueshëm që më kanë dhënë gjatë gjithë kohës.*

# PËRMBAJTIA

<b>Hyrje .....</b>	<b>6</b>
<b>Kapitulli I. RREGULLIMI FREKUENCË – FUQI .....</b>	<b>7</b>
1.1 Rregullimi i frekuencës dhe i fuqisë aktive në sistemin e fuqisë .....	7
1.2 Zgjidhjet ekzistuese të Rregullimit Frekuencë – Fuqi .....	8
1.2.1 Zgjidhjet klasike të rregullimit Frekuencë – Fuqi .....	9
1.2.1.1 Rregullatorët PID të rregullimit Frekuencë – Fuqi.....	9
1.2.1.2 Rregullatorët Adaptiv të rregullimit Frekuencë – Fuqi .....	9
1.2.2 Zgjidhjet bashkëkohore të rregullimit Frekuencë-Fuqi.....	10
1.2.2.1 Rregullatorët dytësore sipas logjikës Fuzzy .....	11
1.2.3 Teknikat bazuar në rrjetat neurale (Artificial Neural Network).....	11
1.2.4 Modeli i algoritmit gjenetik.....	12
1.2.5 Teknikat Hibrde dhe të tjera.....	14
<b>Kapitulli II. MODELET E HALLKAVE TË SISTEMIT TË RREGULLIMIT FREKUENCË - FUQI.....</b>	<b>16</b>
2.1 Hyrje .....	16
2.2 Njësitë gjenëruese të fuqisë.....	16
2.2.1 Turbinat .....	16
2.2.2 Turbinat hidraulike .....	17
2.2.3 Modeli linear i turbinës .....	19
2.2.4 Turbinat e avullit .....	21
2.3 Gjenërorët.....	25
2.4 Rregullatorët e shpejtësisë .....	26
2.5 Sistemet e ndërlidhura të fuqisë .....	31
2.5.1 Linjat ndërlidhëse.....	31
2.5.2 Gabimi i rregullimit të zonës.....	31
2.6 Opërimi në paralel i sistemeve të ndërlidhura të fuqisë.....	32
2.7 Modeli dinamik i një zone të njërive gjenëruese të fuqisë.....	32
2.8 Modeli i transformimit të Laplasit i një zone të sistemit gjenërues të fuqisë.....	33
2.9 Modeli matematik i katër zonave të lidhur ne paralel.....	35
2.10 Rregullimi sekondar i sistemit elektroenergetik të izoluar.....	36
2.11 Rregullimi sekondar i sistemit elektroenergetik të ndërlidhur .....	41
2.12 Përshtatja e parametrave dinamik të rregullatorit të rrjetit.....	44
2.13 Përmbledhje e kapitullit .....	48
<b>Kapitulli III. RREGULLIMI FREKUENCË FUQI PËR SISTEMIN ME KATËR ZONA DUKE PËRDORUR RREGULLATORË TË NDRYSHËM.....</b>	<b>49</b>

3.1 Hyrje .....	49
3.2 Vlerësimi i cilësisë së rregullimit të rregullatorit sekondar .....	53
3.2.1 Kriteret themelore .....	53
3.2.2 Kërkesat e veçanta dhe kriteret që lidhen me proceset e ndryshueshme të rregullimit automatik sekondar.....	54
3.2.3 Kërkesat dhe kriteret që lidhen me analizën e procesit të rregullimit automatik sekondar .....	57
3.3 Rregullimi frekuencë-fuqi me rregullator PID.....	58
3.4 Rregullimi frekuencë-fuqi me rregullator Fuzzy .....	60
3.5 Sinteza e Rregullatorit Fuzzy .....	60
3.5.1 Komponentët e Sistemit Fuzzy .....	60
3.5.2 Avantazhet rregullatorve me logjike Fuzzy .....	61
3.5.3 Projektimi i rregullatorit Fuzzy të propozuar për rregullimin fuqi frekuencë.....	61
3.5.3.1 Përcaktimi i Funksionit Membership .....	61
3.5.3.2 Përcaktimi i rregullave Bazë .....	62
3.5.3.3 Defuzzification .....	62
3.6 Rregullimi frekuencë - fuqi me rregullator Neural .....	64
3.6.1 Cfarë janë rrjetat neurale? .....	64
3.6.1.1 Pse të përdorim rrjetat neurale?.....	64
3.6.1.2 Dobitë e ANN.....	64
3.6.1.3 Rrjetat neurale kundrejt kompjuterave tradicional .....	65
3.6.2 Analiza rregullatorit frekuencë-fuqi dhe sistemit të rregullimit.....	65
3.6.2.1 Struktura e rrjetave neurale .....	65
3.6.2.2 Arkitektura e rrjetës neurale .....	67
3.6.2.3 Vlerësimi i performancës së rregullimit .....	67
3.6.2.3.1 Treguesit e performancës .....	67
3.7 Sinteza e rregullatorit neural NARMA-L2 .....	68
3.7.1 Trajnimi i gabimit të rregullatorit NARMA L2 .....	70
3.7.2 Vlerësimi i të dhënave të trajnimit .....	71
<b>Kapitulli IV. SIMULIMET E SISTEMIT TË FUQISË ME KATËR ZONA DHE ANALIZA E REZULTATEVE.....</b>	<b>72</b>
4.1 Hyrje .....	72
4.2 Rezultatet e simulimeve duke përdorur rregullatorë dytësore të ndryshem .....	73
4.3 KONKLUZIONE TË PËRGJITHSHME DHE REKOMANDIME PËR T'ARDHMEN.....	83
<b>Literatura .....</b>	<b>84</b>
<b>Shtojca 1: Rezultatet e simulimeve për skenare të ndryshëm të operimit të sistemit. ....</b>	<b>87</b>

## HYRJE

Sot, gjithnjë e më tepër po gjen përdorim të gjërë puna në paralel e sistemeve elektroenergjitike. Një sistem i tillë kompleks, i përbërë nga disa sisteme të veçanta të lidhura në paralel me njëra tjetrën, nëpërmjet të ashtuquajturave linjave të eksportit apo linjat e interkonjeksionit siç quhet shpesh sistem energjistik i ndërlidhur. Vetë sistemet që punojnë në paralel me njëri – tjetrin njihen me emrin sisteme të ndërlidhura. Lidhja në paralel e sistemeve energjitike, në krahasim me rastin e punës së veçuar të tyre, ka një sërë epërsish, nga të cilat vlejnjë të përmendim:

1. Një mbajtje të frekuencës shumë më të mirë në rastë normale për faktin se ngacmimet shqetësuse ndjehen më pak lidhur me fuqinë e përgjithshme të sistemit. Kështu, një shkyçje prej 100MW në një sistem me fuqi 500MW përbën 20% të fuqisë P, ndërsa në një sistem me fuqi 5000MW përbën vetëm 2% P.
2. Një mbajtje më të mirë të frekuencës në rast avarie në njërin prej sistemeve. Kështu për mosbalancim të tillë të ngarkesës me fuqinë gjenëruese në njërin sistem, që mund të rrezikontë dhe rënien e tij, ndihma që vjen nga sistemet fqinjë nëpërmjet linjave të interkonjeksionit, është thelbesore në mbajtjen e atij sistemi.

Lind kështu problem i një rregullimi të përshtatshëm të fuqive të shkëmbyera, fuqitë e eksportit ndërmjet sistemeve të ndryshme. Luhatjet e tëpërta të fuqive të eksportit mund të jenë të papranueshme qoftë për motive teknike, që lidhen me mbingarkime të zgjatura në linjat e interkonjeksionit, (që mund të cojë dhe në ndarjen e sistemeve), qoftë për motive ekonomike, mbasi mund të shkaktojë shmangie nga zona e punës ekonomike të burimeve energjitike, si dhe mosrespektim të kontratave për importin - eksport e energjisë ndërmjet sistemeve që punojnë në paralel. Në rastin e një sistemi prej n zonash (sisteme energjitike), ndodhemi përballë problemit të rregullimit jo vetëm të frekuencës por edhe të fuqive të eksportit  $p_e$ .

Në një sistem elektroenergjitik të ndërlidhur të fuqisë, kërkesa për energji ndryshon rastësisht, si pasojë ndryshojnë edhe frekuenca e zonës dhe fuqia transmetuese e linjave të interkonjeksionit. Objektivat e rregullimit të frekuencë-fuqi janë për të minimizuar shmangiet e rastit në këto variabla (frekuenca e zonës dhe fuqinë transmetuese të linjës së interkonjeksionit) dhe për të siguruar që ndryshimet e fuqisë së eksportit në zonën përkatëse të jetë zero. Kur kemi të bëjmë me problemin e rregullimit frekuencë-fuqi në sistemet elektroenergjitike të fuqisë, ngacmimet shqetësuese të jashtme të rastit, ndryshimet e parametrave dhe pasiguria e modelit të sistemit paraqesin sfida të mëdha për rregullatorin dytësor të frekuencës. Kështu procesi i rregullimit i ngacmimeve të fuqisë aktive apo zgjedhja e rregullatorit sekondar është një detyrë gjithnjë e më veshitirë e kontrollit në praktikë. Ky punim paraqet një zgjidhje për problemin e rregullimit frekuencë-fuqi për lidhjen e sistemit elektroenergjetik shqipëtar me sistemet fqinjë. Propozimin e një modeli të rregullatorit dytësor bazuar në teorinë klasike dhe bashkëkohore të rregullimit. Rregullatori është projektuar për një sistem me katër zona të ndërlidhur, me njësi të ndryshme turbinë, duke përfshirë zonën me njësi turbinë pa tëjnxehës (të ftohtë), zonën me njësi turbinë me tëjnxehës (të ngrohtë) dhe zonën me njësi hidraulike (zona 4 Shqipëria). Modeli dinamik i sistemit të fuqisë dhe për rregullatorin dytësor të frekuencës janë ndërtuar në bazë të modeleve matematike dhe janë përdorur për kryerjen e simulimeve dhe nxjerrjen e përfundimeve. Rezultatet dhe analizat e simulimeve për cdo rast, demonstrojnë se Teknika të ndryshme të rregullatorëve kanë performanca të ndryshme për zgjidhjen e problemit të rregullimit të frekuencë-fuqi në sistemet e ndërlidhura të fuqisë, në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit.

# KAPITULLI I

---

## RREGULLIMI FREKUENCË – FUQI

### 1.1 Rregullimi i frekuencës dhe i fuqisë aktive në sistemin e fuqisë

Sistemet elektroenergjitike të fuqisë janë përdorur për të kthyer energjinë natyrore në energji elektrike. Ata transportojnë energjinë elektrike nga çentralet elektrike për në fabrika dhe në shtëpi për të kënaqur të gjitha nevojat e kërkesave për energji elektrike. Për të optimizuar performancën e sistemeve energjitike, është e rëndësishme të sigurohet cilësia e energjisë elektrike. Dihet se për të transmetuar energjinë elektrike përgjithësisht përdoret rryma alternatife trefazore (AC). Gjatë transmetimit të saj, bilanci i fuqive aktive dhe reaktive duhet të ruajë balancën ndërmjet gjenerimit dhe konsumit të energjisë elektrike. Bilanci i fuqisë aktive dhe reaktive korrespondojnë me dy pika punë të ekuilibrit, *frekuencën dhe tënsionin*. Kur një prej të dy bilanceve priset dhe vendoset në një pike të re punë, pikat e ekuilibrit do të ndryshojnë. Një cilësi e mirë e sistemit elektroenergjitik të fuqisë kërkon që, frekuenca dhe tënsioni të mbetën në vlerat e normuara (standarde) gjatë punimit normal. Për Amerikën e Veriut, vlerat standarde për frekuencën dhe tënsionin janë 60 Hz dhe 120 V, ndërsa në vendet europiane 50 Hz dhe 230V.

Megjithatë, përdoruesit e energjisë elektrike ndryshojnë kërkesën për energji në mënyrë rastësore dhe momentale. Për pasojë është e pamundur për të ruajtur balancat ndërmjet fuqive aktive dhe reaktive pa kryer një rregullim ose kontroll të tyre. Si rezultat i disbalancës, vlerat e frekuencës dhe tënsionit do të jenë variabël me ndryshimin e ngarkesës. Kështu, në një sistem kontrolli është thelbësore të eliminohen efektët e ndryshimeve të rastit të ngarkesës për të mbajtur frekuencën dhe tënsionin në vlerat standarde. Megjithëse fuqia aktive dhe reaktive kanë efektë të ndërlidhur mbi frekuencën dhe tënsionin, problemi i rregullimit të frekuencës dhe tënsionit mund të bëhet i ndarë. Frekuenca është shumë e varur nga fuqia aktive, ndërsa tënsioni është shumë i varur nga fuqia reaktive.

Kështu çështja rregullimit në sistemin e fuqisë mund të ndahet në dy probleme të pavarura. Njëri është në lidhje me fuqinë aktive dhe rregullimin e frekuencës, ndërsa tjetri është në lidhje fuqinë reaktive dhe rregullimin e tënsionit. Fuqia aktive dhe rregullimi i frekuencës njihet ndryshe si rregullimi frekuncë – fuqi.

Detyra kryesore e rregullimit frekuencë – fuqi është të mbajë frekuencën konstante kundrejt ndryshimeve të rastësishme të fuqisë aktive të ngarkesës, të cilat janë gjithashtu të referuara si ngacmim shqetësues të jashtëme të panjohura. Një tjetër detyrë rregullimit frekuencë-fuqi është që të rregullojë gabimet e fuqive të eksportit të linjave të

interkonjeksionit. Një sistem i fuqisë është i përbërë nga njësitë gjenëruese, konsumatorët e energjisë elektrike si dhe linjat dhe nënstacionet për transmetimin e saj. Me qëllim rritjen e sigurisë dhe cilesinë e furnizimit me energji të konsumatoreve këto sisteme janë të lidhura ndërmjet tyre nëpërmjet linjave ndërlidhëse. Përdorimi i fuqisë së linjës ndërlidhëse sjell një gabim të ri në problemin e rregullimit, pra gabimet e fuqive të eksportit të linjave ndërlidhëse. Kur një ndryshim i papritur i fuqisë aktive ndodh në një prej zonave të sistemit, kjo zonë do të marrë energji nëpërmjet linjave ndërlidhëse nga zonat e tjera. Por në fund, zona që është subjekt i ndryshimit të ngarkesës duhet të balancojnë atë pa përkrahjen e zonave të tjera. Në këtë mënyrë nuk do të ketë konfliktë ekonomike midis zonave.

Për këtë arsye çdo zonë kërkon një rregullator të veçantë të sistemit frekuencë - fuqi për të rregulluar gabimet e fuqive të eksportit të linjave të interkonjeksionit në mënyrë që të gjitha zonat në një sistem të ndërlidhur të fuqisë mund të vendosin pikat e tyre të punës në mënyrë të veçantë. Një problem tjetër është që sistemet e ndërlidhura të fuqisë sjellin rritje të mëdha si në mënyrë të sistemit të rregullimit dhe në rregullimin e numrit të parametrave kontrollues. Si rezultat, kur modelet janë komplekse të tilla të rendeve të larta të sistemeve të fuqisë, modeli dhe parametrat e përafërta mund të kene shmangje. Prandaj, kërkesa e rregullimit frekuencë - fuqi është që të jetë i qëndrueshëm ndaj pasigurive të modelit të sistemit dhe ndryshimeve të parametrave të sistemit real.

Në përmbledhje, rregullimit frekuencë-fuqi ka dy detyra të mëdha, të cilat janë: të mbajë vlera standarte të frekuencës dhe për të mbajtur fuqinë e eksportit të linjës ndërlidhëse sipas orarit në prezencën e çdo ndryshimi të fuqisë së ngarkesës [1]. Përveç kësaj, rregullimi frekuencë-fuqi duhet të jetë sistem i qëndrueshëm ndaj ngacmimeve të jashtme të panjohura, modelit të sistemit dhe ndryshimit të parametrave të elementëve të sistemit. Rendi i lartë i sistemit të fuqisë, gjithashtu mund të rrisë dhe Kompleksitetin e projektimit të rregullatorit frekuencë-fuqi [2].

## 1.2 Zgjidhjet ekzistuese të Rregullimit Frekuencë – Fuqi

Shumë Teknika kontrolli janë propozuar nga studiuesit në punët fillestare të tyre për të projektuar rregullatorin dytësor. Projektimi dhe sinteza e rregullatorit dytësor bazohet në:

### A. Teknikat klasike të kontrollit

1. Rregullatorët klasike Integrale, proporcional dhe derivatë.
2. Teknikat e kontrollit bazuar në kontrollin adaptiv (Linear Quadratic Regulator (LQR)).

### B. Teknikat e kontrollit të Inteligjencës Artificiale nëpërmjet softëve kompjuterikë

1. Teknika e kontrollit bazuar në llogjikën Fuzzy
2. Teknika e kontrollit bazuar në llogjikën e rrjetave neurale (ANN)
3. Teknika e kontrollit bazuar në algoritmet gjenetike (AG)
4. Teknika Hibride dhe të tjera

Përshkrimi i teknikave të rregullimit të frekuencë-fuqi janë përshkruar nga studiues të ndryshëm dhe janë në qëndër të kërkimeve të studiueseve.



## **1.2.1 Zgjidhjet klasike të rregullimit Frekuencë – Fuqi**

### **1.2.1.1 Rregullatorët PID të rregullimit Frekuencë – Fuqi**

Në industri, rregullatorët proporcional-Integral-derivat (PID) janë përdorur gjerësisht në dekada si rregullatorë të frekuencës së fuqisë. Projektimi i një rregullatori PID në një nga katër zonat e sistemit e ndërlidhur të fuqisë tregohet në kapitullin, ku parametrat e rregullatorit e PI janë të akorduara duke përdorur qasjen eksperimentale. Projektimi i rregullatorit dytësor bazuar në një model të tërë sistemit të fuqisë konsiderohet si një metodë e centralizuar. Aurori K.Rama [14], ka përdorur këtë metodë e centralizuar është futur me një sistem të thjeshtuar me shumë zona për të zbatuar Teknika të tilla të optimizimit në të gjithë modelin e sistemit. Megjithatë, thjeshtimi është bazuar në supozimin se të gjitha nënsistemet e të gjithë sistemit të fuqisë janë identike, kur praktikisht ata nuk janë të tilla. Ky supozim e bën simulimin e modelit të ndryshëm nga sistemi real i fuqisë. Një problem tjetër i metodave të centralizuara është se edhe nëse kjo teknikë është efektive në një sistem të rendit të ulët, ai do të përballë me një rritje eksponenciale të problemit të llogaritjes me rritjen e madhësisë të sistemit. Meqë shkëmbimet e linjave ndërlidhëse janë shoqëruara me ulje të tërmave ndërmjet zonave, madhësia e sistemit të fuqisë mund të decentralizohet në formën nënsistemeve të vogla, duke i trajtuar si shqetësime sinjalet e linjave ndërlidhëse. Teknika të shumta të rregullimit janë aplikuar për të decentralizuar sistemet e fuqisë.

### **1.2.1.2 Rregullatorët Adaptiv të rregullimit Frekuencë – Fuqi**

Kontrolli adaptiv është një metodologji kontrolli të një rregullatori për tu përshtatur me ndryshimin e parametrave të sistemit. Strategjia e kontrollit adaptiv është shumë efektive në përmirësimin e stabilitetit dhe përgjigjes kalimtare të sistemit. Ka një dallim ndërmjet teknikes së kontrollit të linear dhe kontrollit adaptiv. Teknika e kontrolli linear garanton normat e kontrollit për ndryshimin e parametrave të cilet nuk duhet të kalojnë një kufi të caktuar. Ndërsa në rastin e kontrollit adaptiv ato do të ndryshojnë me ndryshimin e kushteve. Autori Ross propozoi një teknike kontrolli me një rregullator adaptiv kompjuterik (EACC).

Tripathi propozoi një rregullator adaptiv i cili zbatohet në një mikroprocesor për rregullimin frekuencë-fuqi. Vajk paraqet një rregullator adaptiv i cili përdor informacion apriori të njohur dhe përmbush karakterin në shumë zona të rregullimit frekuencë-fuqi të sistemit të fuqisë Hungarez. Autori Pan përdor një përshtatje të rregullatorit PI për të përmbushur kushtin e stabilitetit për të marrë parasysh ndryshimet e parametrave të sistemit. Për të realizuar atij i nevojitet vetëm informacioni në dipozicion për gjendjen e variablave të daljes për kontrollin. Sho propozoi një adaptues për rregullimin frekuencë-fuqi me shumë zona bazuar në rregullatorin vetë-sintonizues (STR), për rregullim të plotë të kontrollit automatik të gjeneratorit (AGCS). Liaw propozoi rregullator që përdor një model me sinjal adaptues të sintezës të tilla që performanca e sistemit të kontrollit është e pandjeshem nga ndryshimi i ngarkesës dhe luhatjet e parametrave të sistemit. Ai është projektuar i tilla që vetëm daljet e objektit të rregullimit i japin përgjigje rregullatorit. Një model reference i reduktuar përdoret për të lehtësuar projektimin, duke e bërë rregullatorin me të thjeshtë për tu zbatuar. Rregullatorit me vet-sintonizimi janë gjithashtu një pjesë e skemës së kontrollit adaptiv.

Rregullatorit me vet-sintonizim kanë të optimizuar parametrin e drejtimit të sistemit për përmbushjen e funksionit objektiv i cili mund të zmadhohet ose minimizohet. Në përgjithësi gabimi është minimizuar dhe efica është zmadhuar. Autori Raj [12] përdori një metodologji kontrolli ku teknika të zgjerimit të zonave janë përdorur për vlerësimin e parametrave. Zona e kontrollit të korigjimit të gjeneratorit llogaritet nga një algoritëm vet-sintonizues i nxjerrë nga minimizimi i një funksioni kostoje të përgjithësuar, i cili është i përcaktuar në termat e outputit të sistemit dhe peshën në vendosjen e rregullatorit.

Një nga zhvillimet në fushën e teorisë moderne të kontrollit është në drejtimin e zbatimit të tij në kontrollin optimal i cili lejon inxhinieret të përballojnë dhe problemet që dalin për shkak të strukturas komplekse të sistemit të fuqisë. Zhvillimi i teknikave të projektimit për rregullatorit Frekuencë – Fuqi të sistemit të fuqisë në vitet e fundit është shumë i rëndësishëm. Projektimet e rregullatorit dytësor janë bazuar në skemat e kontrollit adaptiv. Kontributi kryesor i rregullatorit të propozuar është të përmirësojë performancën e rregullimit të rregullatorit konvencional PID. Rregullatori konvencional PID me kompensim sintonizimi në kohë reale ka një performancë superiore në krahasim me rregullatorët konvencional PID.

### 1.2.2 Zgjidhjet bashkëkohore të rregullimit Frekuencë-Fuqi

Kontrolli logjik “0” dhe “1” është një metodë e bazuar në një teori të caktuar binare “0” dhe “1”, në të cilën variablat logjike mund të jetë çdo vlerë ndërmjet 0 dhe 1 në vend të “e vërtetë” dhe “e gabuar”. Kur variablat janë përzgjedhur, zgjedhja do të bëhet përmes funksioneve specifike të logjikës “0” dhe “1”. Rezultatet e hulumtimit të fituara nga aplikimi i teknikës së kontrollit logjik “0 dhe 1” të decentralizimit të problemit të rregullimit frekuencë-fuqi janë propozuar në literaturë të ndryshme. Llogjika “0 dhe 1” bazuar në një skemë rregullimi të njëanëshme të linjës ndërlidhëse në një sistem të fuqisë me shumë njësi me dy zona tregohet në [12], ndërsa një metodë e ngjashme me një cikël të kombinuar të sistemit të fuqisë përfshirë krahasimin midis kontrollit logjik “0 dhe 1” dhe teknikat konvencionale të rregullatorit PID (Proporcional–Integral–Derivues) tregohen në [15].

Algoritmi gjenetik (GA) është një nga algoritmet më popullore të inteligjencës algoritmike kompjuterike. Ai është vërtetuar të jetë efektiv për të zgjidhur problemin kompleks të optimizimit [17], ku tipi i rregullatorit PI - (Proporcional–Integral) nëpërmjet GA dhe matricës lineare jodiagonale (GALMI) është paraqitur në një sistem të decentralizuar të fuqisë me tre zona të përbërë nga nëntë njësi gjenëruese. Në [15], ajo që është gjetur se struktura e GALMI akorduar rregullatorit PI është shumë më e thjeshtë se rregullatori  $H_2/H_\infty$ , edhe pse performancat e dy metodave janë ekuivalente. Shumica e zgjidhjeve të treguara të problemit të sintesës të rregullatorit frekuencë-fuqi janë testuar për qëdrueshmërinë e tyre kundrejt ndryshimeve të mëdha për ngacmim shkallë të ngarkesës. Megjithatë, shumë pak prej hulumtimeve të publikuara merren me ndryshimet variabël të parametrave. Autorët kanë ngritur një normë deri në 15% të hulumtimit për parametrat në një zonë dhe kanë kontrolluar me sukses sjelljen e sistemit duke përdorur një rregullator optimal PID (Proporcional–Integral–Derivues). Megjithatë, në shumë përafrime dhe thjeshtëzime, të cilat janë bërë gjatë procesit të modelimit të sistemit të fuqisë, në të cilën

është projektuar rregullatori, modeli i thjeshtuar i sistemit ka devijime nga sistemi real. Një teknikë kontrolli me një qëndrueshmëri të dukshme kundrejt jo vetëm ndryshimit të parametrave, por edhe pasiguritë e modelit dhe ndryshimit të ngarkesës preferohet në rastet e përdorimit të energjisë elektrike në industri. Teknikat në zhvillim të inteligjencës artificiale (AI) kanë një tipar të përbashkët, dmth kanë aftësi për të përpunuar një informacion kompleks [8]-[9]. Në teknikat AI të gjitha analizat e lidhjeve të shkurtra trefazore mbahen offline, dhe difekti vendoset online brenda një kohë të shkurtër. Mjete të ndryshme të AI janë zbatuar me sukses në funksion të sistemit të fuqisë të tilla si Expert Systems (Sistemet Experte), Artificial Neural Network (ANN), Fuzzy logic dhe algoritmet gjenetike (AG) duke realizuar performanca të dallueshme nga ato konvecionale [10]-[11]. Në mesin e teknikave të ndryshme të AI, modeli i Fuzzy Logic është vërejtur të jetë i zbatueshem dhe tërheqës për trajtimin e problemeve komplekse të cilat mund të jenë të pamundur ose shumë të shtrenjta me metodat konvecionale.

### **1.2.2.1 Rregullatorët dytësore sipas logjikës Fuzzy**

Rregullatorët dytësore sipas logjikës Fuzzy janë rregullatorë inteligjentë të projektuar për të lehtësuar funksionimin normal dhe me më pak lëkundje kur sistemi i nënshtrohet një ndryshim të ngarkesës të papritur [32]. Rregullatori dytësore Fuzzy bazohet në një sistem logjik që quhet logjika e “fuzzy” e cila është shumë me afër të menduarit njërezor dhe gjuhës natyrore se sistemet logjike klasike [33]. Kompleksiteti dhe kushtet shumë të ndryshueshme të sistemit të fuqisë, metodat kontrolluese konvecionale mund të mos japin zgjidhje të kënaqshme. Nga ana tjetër, qëndrueshmëria dhe besueshmëria e tyre i bejnë rregullatorët Fuzzy të dobishëm në zgjidhjen e një game të gjerë problemesh të kontrollit. Rregullatori frekuencë-fuqi me dy zona të sistemit duke përdorur logjikën e algoritmit Fuzzy tregon se është e përshtatshëm [34]. Por rregulli i thjeshtë i fuzzy bazuar në sistemet ekspertë kanë disa të meta si:

- Është e vështirë të fitojnë njohuri
- Nuk ka përshtatje dhe kështu për sistemet me kohë dinamike të ndryshme, ai nuk është në gjendje të funksionojë mirë për shkak të ndryshimeve në sistem.

Për të kapërcyer këto të meta, [35], është propozuar një teknike e re kontrolli inteligjent bazuar në grupe polare Fuzzy. Grupet polare Fuzzy u prezantuan për herë të parë në vitin 1990. Rregullatorët me logjikë polare Fuzzy kryen për të përmirësuar stabilitetin dhe performancën dinamike të sistemit të fuqisë.

### **1.2.3 Teknikat bazuar në rrjetat neurale (Artificial Neural Network)**

Në vitet e fundit, progres të konsiderueshem është bërë në zbatim të ANNs. Kjo për shkak se, ndryshe nga sistemet ekspertë, rrjetet neurale transmetohen në një njohuri (rregulla) bazë, por kërkojnë dhe identifikimin e modeleve, duke u dhënë projektimin dhe trajnimin e duhur [13]. Një rregullator dytësor duke përdorur rrjetin artificial neural është e përshkruar në [13]. Chaturvedi et al. propozoi një rrjet neural të ri. Ky rrjet neural është quajtur si rrjet neural i përgjithësuar (GNN). GNN u zhvilluar duke zgjedhur funksione të

ndryshme të grumbullimit dhe funksionin e pragut në të njëjtën neuron. Është përdorur përhapja e mësimin përmes algoritmit kohor. Rregullatori GNN është shumë i përshtatshëm për kontrollimin e dinamikës së impantit në shumë pak kohë [8]. Bevrani propozoi një model të ri bazuar në Flexible Neural Networks (FNNs) artificial për të projektuar rregullatorin frekuencë-fuqi për një sistem fuqie shumë të madh në një mjedis të parregulluar. Në këtë model, sistemi i fuqisë konsiderohet si një koleksion zonash të ndara të kontrolluara nën skema bilaterale të rregullatorit frekuencë-fuqi. Në rregullatorin PI, jolinearitetet e sistemit nuk llogariten dhe ato janë të paaftë për të fituar një performancë të mire dinamike për një game të gjerë të kushteve operative në një sistem me shumë zona të sistemit të fuqisë. Një strategji për të zgjidhur këtë problem për shkak të natyrës së shpërndarë të sistemit me shumë zona të sistemit të fuqisë është paraqitur duke përdorur një model Multi-Agent Reinforcement Learning (MARL) të dhënë në [13]. G. Raj paraqiti një Artificial Neural Network (ANN) i cili aplikohet për të vet sintonizuar parametrat e rregullatorit PID [12]. Sistemi i fuqisë me shumë është konsideruar për simulim të rregullatorit me vet sintonizim ANN me bazë PID të propozuar.

Pas evoluimit të mjeteve kompjuterike, shumë studiues janë përpjekur për të gjetur një output me të mire. Kështu ata u përpoqen me teknikat e reja të cilat bazoheshin në Genetic Algorithms dhe Particle Sarm. Këto quhen ndryshe gjithashtu teknikat e optimizimit.

#### 1.2.4 Modeli i algoritmit gjenetik

Një teknike e re inteligjente kontrolli është algoritmi gjenetik bazuar në një rregullator frekuencë-fuqi sipas Genetic Algorithms (GA). GA janë teknika kerkimi globale, në bazë të operacioneve të vëzhguara në përzgjedhjen natyrale dhe gjenetike. Ato veprojnë në një popullsi aktuale të përafert [36]. Individet e tërhequr në menyrë të rastësishme, nga i cili është kerkuar përmiresimi. Çdo ndivid është i koduar si vargje (kromozome) ndertuar mbi një alfabet me vetë, psh, alfabetin binar  $\{0,1\}$  në mënyrë që kromzomet të jenë të vendosur në mënyrë unike në fushën kryesorë të variablave. Është gjithashtu e mundur që të përdorin parametrat e ndryshueshëm të drejtpërdrejt për të përfaqësuar kromozomet në zgjidhjen GA.

Operatoret gjenetike mund të ndahen në tre katërgori kryesore riprodhimi, kryqezim dhe mutacion.

- Riprodhimi: Zgjedh individet me të përshtatshëm në popullatën aktuale për tu përdorur në gjenërimin e popullatës tjetër.
- Kryqezime: Zgjedh çiftë, ose grupe të medha individesh për të shkëmbyer informacionin gjenetik njëri me tjetrin.
- Mutacioni: Zgjedh përfaqesime gjenetike individuale që do ndryshohen sipas disa rregullash probabilistike.

Algoritmet gjenetike kanë me shumë gjasa të konvergjojnë në teknika optimale globale se optimizimi konvencional, pasi ata kërkojnë nga një popullsi pikash, dhe bazohen në rregulla probabilistike tranzicioni. Teknika e optimizimit konvencional zakonisht bazohet në metoden përcaktuese “hill-climbing”, e cila, sipas përcaktimit, do të beje një optimizim lokal. Në studimin [36], vlerat optimale të parametrave të  $f1$  (ose)  $f2$  dhe  $\Delta f1$  (ose)  $\Delta f2$  të

cilat minimojnë performancat e një grupi treguesish të cilat janë të lehtë dhe të llogaritur saktë duke përdorur një algoritëm gjenetik. Studiuesit zgjedhën funksione të plota të ndryshme sipas kërkesave dhe të kuptuarit të tyre. Al-Hamouz propozoi “variable structure controller” (VSC) si përgjigje të marrë nga zgjedhja prej GA. Metoda e propozuar ofron një mënyrë optimale dhe sistematike për përzgjedhjen e përgjigjeve në VSC në krahasim me metodat provë dhe të gabuara. Aplikimi i metodës së propozuar në problemin e rregullatorit frekuencë-fuqi zbulon se jo vetëm performanca e sistemit është përmirësuar shumë por gjithashtu përpjekjet e kontrollit është reduktuar shumë krahasim me metodat e mëparshme. Duke përdorur GA dhe nga zgjedhja e duhur e indeksit të performancës që do të vlerësohet, projektuesi mund të arrijë një kompromis ndërmjet devijimit të frekuencës dhe përpjekjes të kontrollit.

Nikzad propozoi se llogaritja e indeksit të performancës për secilin prej individëve në popullatën aktuale mund të simulohet për të marrë vlerën e indeksit të performancës. Aditya propozoi që parametrat optimale të fituar të kontrolluesve të tipeve të ndryshëm janë marrë duke përdorur algoritmin gjenetik (GA) për një sistem fuqie të ndërlidhur me dy zona me njësi gjeneruese hidro. Aditya minimizoi një funksion objektiv për marrjen e parametrave optimal Integral (I), PI, ID dhe PID duke përdorur algoritme gjenetike. Panda propozoi GA krahas të teknikës së zbërthimit të zhvilluar për të marr optimumin e kontrollit të frekuencës-fuqi të sistemit të fuqisë. Në këtë studim, një pike kryqezimi e quajtur gjithashtu kryqezimi Holland u përshtat me një probabilitet PC “[0.6, 0.95] me modifikime në shkëmbimin e materialeve kromozomale.

Ibraheem ka marrë përgjigjen optimale të rregullimit frekuencë-fuqi me ndihmën e GA. Një strategji funksionimi bazuar në strategjinë për të krenatur specifikimet e përgjigjes kalimtare të sistemit të frekuencës dhe të fuqisë dhe si pasoje “area control error” (ACE) është minimizuar në zero. Zona e konsideruar si interkoneksione janë vetëm në AC dhe lidhjet AC janë paralelisht me lidhjet DC. Arivoli vëzhgon performancën e dy zonave identike, me njësi gjeneruese termike me tejnxehës të ndërlidhura me linjat e interkoneksioni AC-DC duke përdorur Mutual Aid Criterion (MAC) me Genetic Algorithm (GA)[37].

Bhongade kanë zhvilluar një model i cili gjithashtu përfshin njësitë Superconductin Magnetic Energy Storage (SMES) për të injektuar ose absorbuar energji aktive në një sistem fuqie të ndërlidhur. Funksionimi i Genetic Algorithm bazuar në rregullatorin PID është testuar në një sistem të New England (39-bus) dhe në rrjetin e sistemit të fuqisë Indian (75-bus) [38].

Nuk ka dyshim se GA jep rezultate më të mira se teknikat e mëparshme, por ajo ka disa probleme si:

- Për të gjetur zgjidhje optimale për problemet komplekse me dimensione të larta, multimodal shpesh kërkon vlerësime funksionesh shumë komplekse.
- Algoritmi gjenetik nuk merret edhe me kompleksitetin. Kjo është, kur numri i elementëve që janë ekspozuar ndaj mutacionit është i madh ka shpesh një rritje eksponenciale në madhësinë e hapësirës së kërkimit.
- GA mund të ketë një tendencë të konvergojë drejt një optimizimi lokal apo dhe pikave arbitrare në vend të optimizimit global të problemit.

- Veprimi në grupe dinamike të dhënash është i vështirë, pasi “Genomes” fillojnë të konvergjojnë në fillim drejt zgjidhjeve të cilat mund të mos jenë të vlefshme për të dhënat e mëvonshme.
- GA nuk mund të zgjidhe në mënyrë efektive problemet në të cilat masa është një masë e vetme e saktë/gabim (si problemet e vendimit), pasi nuk ka asnjë mënyrë për të konverguar në gjetjen e zgjidhjes.

Për problemet specifike të optimizimit dhe problemet e rastit, algoritme të tjera optimizimi mund të jenë zgjidhje më të mira se algoritmi gjenetik (të dhëna të njëjtën kohë llogaritje) si grupi i inteligjencës ( psh, Artificial bee colony, Particle swarm optimization).

### 1.2.5 Teknikat Hibrade dhe të tjera

Për të përmiresuar performancën e sistemit të fuqisë shumë kërkues përdorën teknikat hibrade. Një teknike inteligjente kontrolli e re është projektim i një sistemi të turbullt që kanë propozuar algoritme evolucionare, nga e cila më të njohurat janë sistemet e turbullt gjenetike. Në këtë çështje, ato aplikojnë idenë e sistemeve evolucionare të paqarta tek problemet e rregullatorit frekuencë-fuqi. Du zhvilloi një algoritëm online për rregullatorit e logjikës Fuzzy (FLC) me Algoritëm Gjenetik (GA). Modeli matematik për sistemet me shume zona të përdorur në dokumentat e tyre është një model i një sistemi fuqie i ndërlydhur me katër zona duke marrë dhe efektin jolinear të turbinës me avull dhe kufizimet mbi dhe nën për shkallën e jolinearitetit të gjeneratorit dhe të hidro-turbinës. Abdennour propozon një përforsim optimal përshtatës metode skedulimi për problemin e rregullatorit frekuencë-fuqi. Përforsimet e marra nga GA përdorën për të trajnuar një Adaptive Network bazuar në Fuzzy Influence System (ANFIS) për të siguruar një vendosje të përgjithshme ndërmjet kushteve të operimit dhe përforsimit të kontrollit optimal. Për të lehtësuar projektimin e përforsimit të rregullatorit PI një GA i ri duke përdorur një strategji superiore të kombinuar masat e ngjashme të propozuar nga Junag. Për të përmiresuar performancën e rregullatorit është propozuar projekti i rregullatorit Fuzzy-PI duke hibridizuar një algoritëm gjenetik dhe PSO, e quajtur FPI-HGAPSO. FPI-HGAPSO bazohet në hibridin e algoritmeve gjenetike dhe PSO. Në FPI-HGAPSO, elitat në popullimin e GA janë zgjeruar nga PSO dhe këto zgjerime elitash janë zgjedhur të afërta për kryqezimet dhe operacionet e mutacioneve. Në [38], është propozuar një model ciklik i cili kombinon PSO dhe GA. Në atë metode, individualet janë përditësuar nga PSO fillimisht, pastaj nga GA kur nuk kishte më zhvillime në përshtatjen e vlerave, pastaj përseri tek PSO. Në atë metode, nuk është bërë asnjë modifikim nga origjinali i GA ose PSO. Për të kapërcyer problemet e GA përdoret një teknike me e re dhe shumë me e fuqishme inteligjente llogaritëse në të cilën numri i parametrave që janë përdorur për të gjetur hapësirën totale të zgjidhjeve është shumë herë më i madh krahasuar me ato në GA. Pothiya, i fokusuar në një teknike të re optimizimi të një logjikes Fuzzy bazuar në proportional Integral (FLPI) për rregullatorin frekuencë – fuqi përdori një algoritëm i kërkimit Tabu (MTS). Algoritmi Tabu Search (TS) është një kërkim iterativ që nis nga disa zgjidhje të mundëshme fillestare dhe përpjekjet për të përcaktuar një zgjidhje më të mirë në mënyrën e një algoritmi. Vrdoljak, prezantoi një model të ri të rregullatorit diskret për rregullatorin frekuencë-fuqi. Projektimi i modelit të rregullatorit diskret për rregullatorin frekuencë-fuqi me sjelljen e dëshiruar realizohet duke përdorur një algoritëm gjenetik. Dong, prezantoi një metode të re e cila bazohet në

kontrollin e shuarjes së ngacmimeve aktive (ADRC). Duke vlerësuar dhe lehtësuar efektin total të pasigurive të ndryshme në kohë reale. Ganpathy propozoi një metode të re në projektimin e rregullatorëve të decentralizuar duke përdorur Multi-Objective Evolutionary Algorithm (MOEA), për rregullatori frekuencë-fuqi në sistemet e fuqise e ndërlidhur me linjat paralele AC-DC. Gjendja e qëndrueshme e Multi-Objective Evolutionary Algorithm bazohet në konceptin e e-dominance.

# KAPITULLI II

---

## MODELET E HALLKAVE TË SISTEMIT TË RREGULLIMIT FREKUENCË - FUQI

### 2.1 Hyrje

Hapi i parë në analizën dhe projektimin e sistemeve të kontrollit është modelimi matematik i sistemit. Dy metodikat më të përdorura janë metoda e funksionit transmetues dhe ajo e variablave të gjëndjes. Metoda e variablave të gjëndjes mund të aplikohet për të përshkruar njëkohësisht sistemet lineare dhe sistemet jolineare. Për të përdorur funksionin transmetues dhe ekuacionet lineare të gjëndjes, sistemi fillimisht duhet të linearizohet. Bëhen përafrime për të linearizuar ekuacionet matematike të cilët përshkruajnë sistemin në fjalë dhe kështu përfitohet modeli i funksionit transmetues për komponentët e kërkuara

Një hyrje e plotë e modeleve dinamike e sistemeve të përgjithshme të fuqisë gjendet në literaturat [1] dhe [2]. Në këtë kapitull, do të trajtohen, modelimi i një sistemi tipik gjenëruës të fuqisë, duke përfshirë modelimin e tre llojeve të njërive gjenëruese, modelimin e linjës ndërlidhëse ndërmjet zonave dhe modelimin e operimit në paralel të zonave të ndërlidhura. Transformimi i Laplasit i një zone të decentralizuar të sistemit të gjenerimit të fuqisë do të shërbejnë për analizat e mëvonshme me anë të software-rit inxhinierik Matlab/Simulink.

### 2.2 Njësitë gjenëruese të fuqisë

#### 2.2.1 Turbinat

Njësia e turbinës në sistemin e ndërlidhur të fuqisë përdoret për të transformuar energjinë natyrore të ujit, të tillë si energjia e avullit ose e ujit në fuqi mekanike ( $\Delta P_m$ ) që transmetohet boshtin e rrotorit të gjeneratorit. Në modelin tonë të rregullimit frekuencë-fuqi që kemi marrë në analizë, ekzistojnë tri lloje turbinash të përgjithshme: Zona 4 (Shqipëria) dhe Zona 1 (Mali i Zi) me njësi turbinë hidraulike Zona 2 (Kosova) me njësi turbinë pa tëjnxehje, Zona 3 (Greqia) me njësi turbinë me tëjnxehje dhe, të cilat modelohen nga funksionet e transmetuese përkatëse për secilën prej tyre.



## 2.2.2 Turbinat hidraulike

Nëse uji rrjedh nga një nivel i lartë në një nivel më të ulët përmes një turbinë hidraulike energjia potenciale e ujit e depozituar në një rezervuar në lartësi kthehet në punë mekanike në boshtin e turbinës. Turbina mund të jetë një turbinë shtytëse ose një turbinë me kundërveprim. Në turbinat shtytëse si turbinat Pelton, e gjithë energjia e mundëshme e ujit konvertohet në energji kinetike ndërsa uji kalon nëpër tubacion. Uji formon një rrymë të lirë ndërsa largohet nga tubacioni dhe godet lopatat ku energjia kinetike kthehet në punë mekanike. Në turbinat me kundërveprim si turbinat Frensis vetëm një pjesë e energjisë së ujit kthehet në energji kinetike ndërsa uji kalon nëpërmjet portave. Në të dy turbinat fuqia kontrollohet duke rregulluar rrjedhën nëpër turbinë me anë të portave në turbinat me kundërveprim dhe me anë të një maje ose një shtize në turbinat shtytëse. Ajo që kërkohet është një përshkrim matematik se si fuqia e turbinës ndryshon kur ndryshon pozicioni i aparaturës rregulluese. Figura 2.1 tregon një skemë të instalimit të një turbinë ku uji rrjedh poshtë nëpërmjet portës dhe përmes turbinës përpara se të derdhet. Ndërsa në figurën 2.2 jepet modeli matematik jolinear i turbinës hidraulike.




Figura 2.1. Skema e instalimit të një turbine hidraulike




Figura 2.2. Modeli matematik jolinear i turbinës hidraulike

Për një turbinë hidraulike forca në bosht jepet me shprehjen si me poshtë:

$$\rho L \frac{dQ}{dt} = F_{neto} \quad (2.1)$$

ku:  $Q$ , → prurja,  
 $L$ , → gjatësia e portës,  
 $\rho$ , → dendësia specifike e fluidit.

Forca neto në uje mund të përftohet duke konsideruar presionin të drejtuar drejt tubacionit. Në hyrje të tubacionit forca në uje është në proporcion me lartësinë statike  $H_s$ , ndërsa në portë është në proporcion me lartësinë  $H$  mbi turbinë. Për shkak të efektëve të ferkimit në tubacion, është gjithashtu një forcë ferkimi në uje e përfaqësuar nga lartësia e rënies e  $H_1$  kështu forca neto e ujit në tubacion jepet:

$$F_{neto} = (H_s - H_1 - H) S \rho g \quad (2.2)$$

Ku  $S$  është seksioni tërthor i tubacionit dhe  $g$  është nxitimi i rënies së lirë. Duke zëvendësuar forcën neto të formula.2.1

$$\rho L \frac{dQ}{dt} = (H_s - H_1 - H) S \rho g \quad (2.3)$$

Është e zakonshme që të kthehet ky ekuacion në një ekuacion të përshtatshëm bazë. Megjithëse ky sistem bazë është arbitrar, lartësia bazë  $h_{baz}$  merret si lartësia statike mbi turbinën në këtë rast  $H_s$ , ndërsa prurja bazë  $q_{baz}$  merret si prurja që kalon përmes turbinës me portat tërësisht të hapura dhe lartësia nga turbina është e njëjtë me  $h_{baz}$ . Duke i pjestuar të dy anët e formulës 2.3 me  $q_{baz}$  dhe  $h_{baz}$  kemi:

$$\frac{dq}{dt} = \frac{1}{T_w} (1 - h_1 - h) \quad (2.4)$$

ku:  $q = \frac{Q}{q_{baz}}$  → prurja normale  
 $h = \frac{H}{h_{baz}}$  → presioni i lartësise  
 $T_w = \frac{L q_{baze}}{S g h_{baze}}$  → koha e fillimit të ujit.

Teorikisht  $T_w$  përcaktohet si koha që i duhet rrjedhës së ujit në një tubacion për tu ndryshuar në një vlerë të njëjtë me  $q_{baz}$  kur lartësia ndryshon në një vlerë të njëjtë me  $h_{baz}$ . Lartësia e rënies  $h_1$  është në proporcion të katrorit të prurjes dhe varet nga përmasat e tubacionit dhe nga faktori fërkues. Gjatë modelimit të turbinës karakteristikat hidraulike dhe fuqia mekanike duhet patjetër të modelohen.

Se pari, presioni i lartësise për rreth turbinës lidhet me prurjen duke supozuar se turbina mund të përfaqesohet nga karakteristika e valvulës mund të shkruajmë:

$$Q = kc\sqrt{H} \quad (2.5)$$

Ku  $c$  është pozicioni i portës midis 0 dhe 1 dhe  $k$  është një konstante. Me portën tërësisht të hapur  $c = 1$  dhe ky ekuacion mund të thjeshtëzohet duke i pjestuar të dy anët e tij me  $q_{baze} = k\sqrt{h_{baze}}$  për të marrë:

$$q = c\sqrt{h} \quad (2.6)$$

Se dyti fuqia e zhvilluar nga turbina është në proporcion me prodhimin e prurjes me lartësinë. Arsyeja pse turbina nuk ka rendiment 100% është se prurja pa ngarkesë  $q_{nl}$  i zbritët prurjes aktuale për të dhënë në parametra të thjeshtëzuar:

$$P_m = h(q - q_{nl}) \quad (2.7)$$

Fatkeqesisht kjo shprehje është në një sistem njësisish të ndryshem nga ata që përdorën për gjeneratorin parametrat e të cilit janë thjeshtëzuar në njësi bazë, kështu formula 2.7 mund të shkruhet:

$$P_m = A_t h(q - q_{nl}) \quad (2.8)$$

Ku faktori  $A_t$  përfshihet për arsye të ndryshimit të njësive bazë. Vlera e ketij faktori mund të përcaktohet duke konsideruar funksionimin e turbinës në ngarkesë nominale kur:

$$P_m = A_t h_n (q_n - q_{nl}) = \frac{\text{fuqinë e turbinës (MW)}}{\text{Fuqinë nominale të gjeneratorit (MVA)}} \quad (2.9)$$

Dhe prapashtësa  $n$  tregon vlerën e parametrave në ngarkesë nominale. Duke shkruajtur ndryshe formulën 2.9 kemi:

$$A_t = \frac{\text{fuqinë e turbinës (MW)}}{\text{Fuqinë nominale të gjeneratorit (MVA)}} = \frac{1}{h_n (q_n - q_{nl})} \quad (2.10)$$

### 2.2.3 Modeli linear i turbinës

Modeli klasik i turbinës hidraulike përdor një model të linearizuar të modelit jo linear. Një model i tille është i vlefshem për ndryshime të vogla të fuqisë mekanike dhe mund të përftohet duke linearizuar ekuacionet 2.5, 2.6, dhe 2.8 për rreth një pike punë fillestare për të dhënë:

$$\begin{aligned}\frac{d\Delta q}{dt} &= -\frac{\Delta h}{T_w} \\ \Delta q &= \frac{\partial q}{\partial c} \Delta c + \frac{\partial q}{\partial h} \Delta h \\ \Delta P_m &= \frac{\partial P_m}{\partial h} \Delta h + \frac{\partial P_m}{\partial q} \Delta q_m\end{aligned}\quad (2.11)$$

Duke përfshire operatorin e Laplasi  $s$  dhe duke hequr  $\Delta h$  dhe  $\Delta q$  nga ekuacioni marim:

$$\frac{\Delta P_m}{\Delta c} = \frac{\left[ \frac{\partial q \partial P_m}{\partial c \partial q} - s T_w \frac{\partial P_m \partial q}{\partial h \partial c} \right]}{1 + s T_w \frac{\partial q}{\partial h}} \quad (2.12)$$

Ku derivatët e pjesëshëm janë:

$$\frac{\partial q}{\partial h} = \frac{1}{2} \frac{c_0}{\sqrt{h_0}} \quad \frac{\partial q}{\partial c} = \sqrt{h_0} \quad (2.13)$$

$$\frac{\partial P_m}{\partial q} = A_t h; \quad \frac{\partial P_m}{\partial h} = A_t (q_0 - q_{nl}) \approx A_t$$

Prapashtësa 0 tregon vlerat fillestare. Duke zëvendësuar ne formulën 2.11 dhe duke shënuar me  $q_0 = c_0 \sqrt{h_0}$  kemi:

$$\frac{\Delta P_m}{\Delta c} = A_t h_0^{3/2} \frac{1 - s T_w'}{1 + s T_w'} \quad (2.14)$$

Ku:

$$T_w' = T_w \frac{q_0}{h_0} = \frac{L}{Sg} \frac{Q_0}{H_0}$$

Zakonish  $T_w'$  varion nga  $0.5 \div 5s$

Ky është përcaktimi klasik i  $T_w'$  por ai varet nga vlerat e lartësise dhe të prurjes në piken e linearizuar. Turbina hidraulike në zonën 4 kanë fazën jo minimale të njësisë për shkak të inercisë së ujit. Në turbinën hidraulike, fillimisht reagimi i presionit të ujit është në drejtim të kundërt me ndryshimit pozicionin të aparatit drejtues dhe rimëkëmbet pas reagimit të rastit. Kështu, funksioni transmetues i turbinës hidraulike shprehet në formën e mëposhtme :

$$G_H(s) = \frac{\Delta P_m(s)}{\Delta P_v(s)} = \frac{-T_w' s + 1}{(T_w'/2) s + 1} \quad (2.15)$$

$T_w'$ : është koha e futjes së ujit në turbinë [1].

Ne figurën 2.3 jepet bllok skema e zëvendësimit të turbinës hidraulike.




Figura 2.3 Turbina hidraulike: a) modeli linear. b) përgjigjia e modelit linear të turbinës ndaj një ndryshimi shkallë njësi në pozicionin e portës.

#### 2.2.4 Turbinat e avullit

Turbinat e avullit përdoren gjerësisht në të gjithë botën për të siguruar fuqi mekanike tek gjeneratori. Modeli matematik i turbinës do të përftohet duke përdorur një model të thjeshtë të një rrjedhe avulli përmes një ene sic tregohet në figurën me poshtë.




Figura 2.4 Modeli i rrjedhes së avullit në një enë: (a) vëllimi i enës, (b) bllok skema .

Ena shkakton një vonese në kohë në sistem, sa që ndryshimeve në rrjedhën e ajrit në hyrje i duhet një kohë e caktuar që të mberrijnë në dalje. Kjo vonesë kohë mund të llogaritët duke marrë parasysh një vëllim  $V$  siç tregohet në figurën 2.4 (a). Në këtë diagramë  $m$  është masa e avullit në enë, p është presioni i avullit, ndërsa  $\dot{m}_1$  dhe  $\dot{m}_2$  janë sasia e avullit në hyrje dhe

në dalje. Sasia e avullit në enë është konstante kur:  $\dot{m}_1 = \dot{m}_2$ . Kur rrjedha e avullit në hyrje ndryshon si pasojë e ndryshimit të pozicionit të valvulës atëhere sasia e avullit në enë do të ndryshojë në mënyrë proporcionale me diferencën e sasisë e rrjedhës në hyrje me atë në dalje, e cila jepet:

$$dm/dt = (m_1 - m_2) \quad (2.16)$$

Nëse temperatura e avullit është konstante atëhere ndryshimi i masës në enë duhet të rezultojë si shkak i ndryshimit të presionit, dhe ky ekuacion mund të shkruhet si me poshtë:

$$\dot{m}_1 - \dot{m}_2 = \frac{dm}{dt} = \frac{\partial m}{\partial p} \frac{dp}{dt} = V \frac{\partial}{\partial p} \left( \frac{1}{v} \right) \frac{dp}{dt} \quad (2.17)$$

ku  $v$  është vëllimi specifik i avullit në një presion të dhënë.

Duke supozuar se rrjedhja e avullit është në proporcion me presionin në enë:

$$\dot{m}_2 = \dot{m}_0 \frac{p}{p_0} \quad \text{ose} \quad \frac{dp}{dt} = \frac{p_0}{\dot{m}_0} \frac{d\dot{m}_2}{dt} \quad (2.18)$$

ku:

$$\dot{m}_0 = \dot{m}_1(t=0) = \dot{m}_2(t=0) \quad \text{dhe} \quad p_0 = p(t=0)$$

duke zëvendësuar formulën 2.17 tek formula 2.18 marim:

$$\dot{m}_1 - \dot{m}_2 = T \frac{d\dot{m}_2}{dt} \quad (2.19)$$

ku:

$$T = V \frac{p_0}{\dot{m}_0} \frac{\partial}{\partial p} \left( \frac{1}{v} \right)$$

Është një konstante kohë që i korespondon masës së avullit në enë. Duke aplikuar transformimin e Laplasit dhe shkruar funksionin transmetues marim:

$$\frac{\dot{m}_2(s)}{\dot{m}_1(s)} = \frac{1}{(1+Ts)} \quad (2.20)$$

i cili i korespondon bllokut të inercisë figura 2.4 (b).

Figura 2.5 tregon se si ekuacioni i mesipërm mund të përdoret për të modeluar vargun e përbërë nga turbinë me një rinxehës. Një skemë e kësaj marrvëshjeje, figura 2.5(a) tregon se si avulli kalon përmes valvulës së kontrollit të rregullatorit të shpejtësisë dhe hyrjen e tubacionit në dhomën e avullit HP (A). Kur largohet nga dhoma, avulli kalon në turbinën

HP përpara se të hyje në fazën e nxehtës ndërmjet turbinave HP dhe IP. Pasi është nxehtë avulli kalon valvulat ndërprerëse në turbinën IP, dhe më pas nëpërmjet tubacioneve shkon tek turbina LP.







Figura 2.5. Turbina me një tejnxehe: (a) skema, (b) bllok skema, (c) bllok skema e transformuar, (d) përgjigjia kalimtare e modelit linear të turbinës e shkaktuar nga një ngacmim shkallë njësi në pozicionin e valvulës.

Modeli matematik i një sistemi të tilla si ai i dhënë në figurën 2.5.b, mund të ndahet në dy pjesë. Së pari si, fuqia e nxjerrë nga një turbinë është në proporcion me masën e rrjedhës së avullit  $m_s$ , çdo fazë e turbinës mund të modelohet me një konstante  $\alpha, \beta, \gamma$  të cilat i korespondojnë një pjesë nga fuqia totale e turbinës e zhvilluar në faza të ndryshme të turbinës me  $\alpha + \beta + \gamma = 1$ . Për rastin e turbinave me një rinxehës këto konstante janë:  $\alpha = 0.3$ ,  $\beta = 0.4$  dhe  $\gamma = 0.3$

Pjesa e dytë e modelit të turbinës i përket akumulimit të dhomës së avullit dhe tubave lidhës, dhe i korrespondon figura 2.5 (b). Vlerat tipike të parametrave janë:

$$T_A = 0.1 \div 0.4s ; T_B = 4 \div 11s ; T_C = 0.3 \div 0.5s ; \alpha = 0.3 , \beta = 0.4 , \gamma = 0.3$$

Duke supozuar se nuk ka kontroll tek valvulat ndërprerëse bllok skema e figures 2.5 (b) mund të thjeshtohet siç është e treguar në figurën 2.5 (c), duke kombinuar të tre blloqet e inercisë duke dhënë një bllok ekuivalent të rendit të tretë me këto parametra të kombinuar:

$$a_1 = T_A + T_B + T_C,$$

$$a_2 = T_A T_B + T_A T_C + T_B T_C$$

$$a_3 = T_A T_B T_C$$

$$b_1 = a(T_B + T_C) + \beta T_C$$

$$b_2 = a T_B T_C$$

Ku konstantia e kohës së tejnxehtësit  $T_B$  është disa herë më e madhe se konstantet e tjera  $T_A$  dhe  $T_C$ , modeli i turbinës mund të thjeshtohet duke supozuar se  $T_A \approx 0$  ose dhe  $T_A \approx T_C \approx 0$ , mund të reduktohet modeli i turbinës respektivisht në model të rendit të parë ose të rendit të dytë. Një turbinë avulli pa tejnxehtës mund të modelohet me një bllok të rendit të parë me konstante kohë  $T_A = 0.2 \div 0.5s$  dhe me  $\alpha = 1$ ,  $\beta = \gamma = 0$ ,  $T_B = T_C = 0$ .

Një krahasim i përgjigjeve në kohë i një turbinë me tejnxehtës me atë pa tejnxehtës me një rritje të ngacmimit shkallë njësi në hapjen e valvulës rregulluese  $\Delta c_{GV}$  është treguar në figurën 2.5(d). Kur hapja e valvulës rritet ashtu rritet edhe zona e valvulës rregulluese  $G_v$ , atëherë për një presion konstant në kazan rrjedha e avullit rritet.



Turbina pa tëjnxehje në Zonën 1 është modeluar sipas një modeli të rendit të parë. Ka një kohë vonese (e përcaktuar nga  $T_{ch}$ ) ndërmjet hapje/mbylljes së aparatit drejtues dhe momentit rrotullues të turbinës. Funkzioni transmetues për turbinën pa tëjnxehës shprehet si mëposhtë:

$$G_T(s) = \frac{\Delta P_m(s)}{\Delta P_v(s)} = \frac{1}{T_{ch}s + 1} \quad (2.21)$$

ku:  $\Delta P_v(s)$  është ndryshimi pozicionit valvul/portë [1].

Turbina me tëjnxehje në Zonës 3 është modeluar e rendit të dytë, pasi kanë etapa të ndryshme për shkak të nivelit presionit të lartë dhe të ulët të avullit.

Funksioni i transmetues i turbinës me tëjnxehje përfaqësohet si mëposhtë:

$$G_T(s) = \frac{\Delta P_m(s)}{\Delta P_v(s)} = \frac{F_{hp} T_{rh} s + 1}{(T_{ch}s + 1) \cdot (T_{rh}s + 1)} \quad (2.22)$$

ku:  $T_{rh}$  qëndron me presion të ulët në kohën e ngrohjes së avullit dhe  $F_{hp}$  paraqet vlerësimin e stadi me presion të lartë [2].

### 2.3 Gjenërorët

Njësia e gjeneratorit në sistemin e fuqisë shëndron fuqinë mekanike të marrë nga agregati i turbinës në energji elektrike. Por për zgjidhjen e problemit të rregullimit frekuencë-fuqi ne fokusohemi në madhësitë në dalje e shpejtësisë së këndore të rotorit (frekuenca e sistemit të ndërlidhur të fuqisë) të gjeneratorit në vend të transmetimit të energjisë. Meqënëse energjia elektrike është e vështirë për tu akumuluar në sasi të mëdha, duhet që të mbahet bilanci midis fuqisë së gjenëruar dhe fuqisë së kërkuar për konsum.

Sapo ndodh një ndryshim i ngarkesës, fuqia mekanike e dërguar nga turbina është në përpjestim të drejtë me energjinë elektrike të gjenëruar nga gjeneratori. Ndryshimi mes fuqisë mekanike ( $\Delta P_m$ ) dhe fuqisë elektrike ( $\Delta P_{el}$ ) është i lidhur me shmangien e shpejtësisë këndore të rotorit ( $\Delta \omega_r$ ), e cila mund të shndërrohet në një ndikim tërthortazi të ndryshimit të frekuencave ( $\Delta f$ ), duke u shumëzuar me  $2\pi$ .

Marrëdhëniet në mes të  $\Delta P_m$  dhe  $\Delta f$  është paraqitur në figurën 2.6, ku  $M$  është konstante e inercisë së gjeneratorit [1].




Figura 2.6: Blllokskema e grupit të gjeneratorit.

Fuqia e ngarkesës mund të zërthehen në ngarkesa rezistive ( $\Delta P_L$ ), të cilat mbetën konstante kur shpejtësia rotorit ndryshon dhe fuqitë motorike që ndryshojnë me shpejtësinë e ndryshimit të ngarkesës [1].

Nëse fuqia mekanike mbetet e pandryshuar, fuqitë motorike do të kompensojnë ndryshimin e ngarkesës në një shpejtësi të rotorit që është i ndryshëm nga një vlerë e caktuar, e cila është treguar në figurën 2.7, ku ( $D$ ) është konstante e rregullimit së ngarkesës [1].




Figura 2.7: Blllokskema e gjeneratorit me efektin e rregullimit të ngarkesës.

Forma e reduktuar e figurës 2.7 është paraqitur në figurën 2.8, i cili është modeli i gjeneratorit që kemi në plan të përdorim për projektimin e rregullatorit frekuencë-fuqi. Transformimi i Laplasit përfaqësohet në blllokskemën e figurës 2.8:

$$\Delta P_m(s) - \Delta P_L(s) = (Ms + D)\Delta F(s) \quad (2.23)$$





Figura 2.8: Reduktimi i blllokskemës së gjeneratorit efektin e rregullimit të ngarkesës.


## 2.4 Rregullatorët e shpejtësisë

Rregullatorët e shpejtësisë janë njësitë që janë përdorur në sistemet e energjisë për të rregulluar shmangiet e frekuencës të shkaktuar nga ndryshimi i ngarkesës dhe ti eliminojë ato duke ndryshuar madhësitë në hyrje të turbinave. Sistemi rregullues për turbinat


hidraulike është i ndryshem në shumë mënyra nga ata të përdorur tek turbinat e avullit. Se pari, një forcë shumë e madhe kërkohet për të levizur portën e ujit, se dyti përgjigjia karakteristike e turbinës hidraulike ndaj një ndryshimi në pozicionin e valvulës duhet të kompensohet mjaftueshëm. Për të siguruar forcën e mjaftueshme për të venë në lëvizje portën përdoren dy motorë ndihmës siç tregohet në figurën 2.9.a. Në të njëjtën mënyrë si tek turbinat e avullit, rregullatori i shpejtësisë vepron nëpërmjet një sistemi levash në valvulën drejtuese e cila kontrollon prurjen e ujit në motorin ndihmës drejtues. Motori ndihmës me tëj vepron në valvulën e motorit kryesor i cili kontrollon pozicionin e portës.



a)



b)



c)

Figura 2.9. Bllok skema e sistemit rregullues të turbinave hidraulike

Bllok skema e plotë e sistemit rregullues tregohet ne figurën 2.9.b. Motori ndihmës kryesor është modeluar nga një element intëgrues, me konstante kohë të intëgrimit  $T_g$  dhe me dy limitues. Limituesi i parë kufizon pozicionin e portës midis tërësisht të hapur dhe tërësisht të mbyllur, ndërsa i dyti kufizon shpejtësinë me të cilën porta mund të levizet. Motori ndihmës drejtues është modeluar me një element i rendit të parë me një konstante kohë  $T_p$ .

Vlerat tipike të rekomanduara të parametrave janë:

$$T_p = 0,04s ; T_g = 0,2s ; T_r = 5T_w ; \delta = 2,5T_w/T_m \text{ dhe } \rho = 0,03 \div 0,06$$

Ku  $T_m$  është konstantia mekanike e kohës se agregatit turbinë-gjenëror.

Tabela 2.1: Vlerat tipike të parametrave të sistemit rregullues të turbinave

Tipi i turbinës	$\rho$	$T_1(s)$	$T_2(s)$	$T_3(s)$	$T_4(s)$
Avulli	0,02 – 0,07	0,1	0,2 – 0,3	0	–
Hidraulike	0,02 – 0,04	–	0,5	5	50

Nëse jo linearitetet të përfaqësuara nga limituesit neglizhohen për momentin sistemi mund të përshkruhet nga një funksion transmetues i rendit të tretë :

$$\frac{\Delta c}{\Delta \omega} = \frac{(1+T_r s)}{\rho} \frac{1}{\frac{T_p T_r T_g}{\rho} s^3 + \frac{(T_p + T_r) T_g}{\rho} s^2 + \frac{T_g + T_r (\rho + \delta)}{\rho} s + 1} \quad (2.24)$$

Meqënëse konstantia e kohës  $T_p$  është disa here me e vogel se konstantet e kohës  $T_g$  dhe  $T_r$  ajo mund të mos meret parasysh duke na dhënë funksionin transmetues të rendit të dytë:

$$\frac{\Delta c}{\Delta \omega} = \frac{(1+T_3 s) K}{(1+T_2 s)(1+T_4 s)} \quad (2.25)$$

Ku :

$$K = 1/\rho$$


Nëse portat limituese janë shtuar në funksionin transmetues përfitohet bllok skema rregulluese e thjeshtuar e treguar në figurën 2.9.c dhe është e njëjtë me sistemin e thjeshtuar të përdorur për të prezantuar rregullatorët e turbinave me avull. Funksioni transmetues i rregullatorit të shpejtësisë jepet si mëposhtë :

$$G_{TDC}(s) = \frac{\Delta P_m(s)}{\Delta P_v(s)} = \frac{T_R s + 1}{T_R (R_T/R) s + 1} \quad (2.26)$$


ku:

$T_R$ ,  $R_T$  dhe  $R$  përfaqësojnë kohën e ristartimit, kompesimin e përkohshëm si edhe kompesimi i përhershëm respektivisht [1].

Turbina me tejnxehtë të treguar ne figurën 2.10(a) është e pajisur me dy setë valvulash kontrolli dhe me dy setë valvulash ndalimi emergjence. Normalisht kontrolli i turbinës është i projektuar për rregullimin e pozicionin e valvulës hyrese dhe asaj ndërprerëse, ndërsa valvulat ndaluese emergjentë mbahen të hapura plotësisht dhe mund të përdoren vetëm në rastet emergjentë për të ndaluar turbinën. Përderisa të dy setët e valvulave ndaluese normalisht janë të hapura plotësisht, ato mund të mos meren parasysh në modelim. Megjithëse mënyra në të cilën kontrolli i valvulave rregulluese dhe i valvulave ndërprerëse është e koordinuar varet nga qëllimi i veprimit kontrollues, tipi i rregullatorit etj.



a)



b)

Figura 2.10. Rregullatori hidro-mekanik i turbinave të avullit: a) bllok skema, b) diagrama funksionale

Të dhënat e përgjithshme të rregullatorit mund të përfshihen në një model kryesor i aftë të përfaqësojë të dy rregullatorët hidro-mekanik dhe elektro-hidraulik. Me qëllim për të zhvilluar këtë model rregullues do të përdoret diagrama funksionale e rregullatorit hidro-mekanik e treguar në figurën 2.10.a. Kjo digramë tregon elementët kryesore të rregullatorit hidro-mekanik të tille si dhënësi i shpejtësisë, rregullatori, përforcuesi i shpejtësisë, motorët ndihmës si edhe valvulat kontrolluese të avullit. Elementët në këtë diagrame funksionale janë modeluar siç tregohet në bllok skemën e treguar në figurën 2.10.b.

Rregullatori është modeluar me një përforcues  $K=1/\rho$ . Servomotori kryesor, i cili altërnon pozicionin e valvulave rregulluese është modeluar nga një intëgrues se bashku me dy limitues. Limituesi i parë është i nevojshem për të mbrojtur turbinën nga hapja e shpejtë ose mbyllja e valvulave të avullit. Limituesi i dytë kufizon pozicionin e valvulës nga tërësisht të hapur në tërësisht të mbyllur. Duke supozuar se presioni i kazanit të avullit mbetet konstant  $P_k=P_m(t=0)=P_0$  bllok skema rregulluese mund të thjeshtohet si tregohet ne figurën 2.11.




Figura 2.11. Modeli i thjeshtuar i rregullatorit

## 2.5 Sistemet e ndërlidhura të fuqisë

### 2.5.1 Linjat ndërlidhëse

Në një sistem të ndërlidhur të fuqisë, zona të ndryshme janë të lidhura me njëra tjetrën nëpërmjet linjave ndërlidhëse. Kur frekuencat në dy zonat janë të ndryshme, ndodh një shkëmbim fuqie nëpërmjet linjave ndërlidhëse që lidhin këto dy zona. Lidhjet e linjave ndërlidhëse mund të modelohen siç është treguar në figurën 2.12. Përfaqësimi i transformimit të Laplasit e bllokskemës në figurën 2.12 jepet nga  $T_{ij}$

$$\Delta P_{tieij}(s) = \frac{1}{s} \cdot T_{ij} \cdot (\Delta F_i(s) - \Delta F_j(s)) \quad (2.27)$$

ku:

$\Delta P_{tieij}$  është fuqia e shkëmbimit e linjave ndërlidhëse midis zonave  $i$  dhe  $j$ , dhe  $T_{ij}$  është koeficienti i sinkronizimit të momentit rrotullues të linjave ndërlidhëse midis zonës së  $i$  dhe  $j$ , [1].

Nga Figura 2.12, ne mund të shohim se gabimi i fuqisë së eksportit është integrali i diferencave të frekuencave midis dy zonave :




Figura 2.12: Skema strukturore e linjave të interkonjeksionit të sistemit të ndërlidhur të fuqisë

### 2.5.2 Gabimi i rregullimit të zonës

Siç është diskutuar në Kapitullin I, qëllimet e rregullimit frekuencë-fuqi nuk janë vetëm për të eliminuar gabimet e frekuencave në çdo zonë, por edhe për të drejtuar fuqitë e eksportit të linjave ndërlidhëse sipas planit [1]. Pra gabimi i fuqisë së eksportit të linjës ndërlidhëse është integrali i diferencave të frekuencave ndërmjet zonave, në qoftë se ne kontrollojmë gabimin e frekuencave dhe i çojmë drejt zeros, ndonjë nga gabimet në gjëndjet e qëndrueshme në frekuencën e sistemit do të rezultojë në gabimet e fuqisë së eksportit në linjat ndërlidhëse.

Prandaj ne duhet të përfshijmë në hyrje të sistemit të kontrollit si informacion dhe gabimin e fuqisë së eksportit të linjës së interkonjeksionit. Si rezultat i kësaj, një gabim i rregullimit të zonës (ACE) është përcaktuar si mëposhtë :

$$ACE_i = \sum_{j=1, \dots, n, j \neq i} \Delta P_{tieij} + B_i \cdot \Delta f_i, [1] \quad (2.28)$$

ku

$B_i$  është karakteristika e përgjigjes së frekuencës për zonën e  $i$  dhe

$$B_i = D_i + \frac{1}{R_i} \quad (2.29)$$

Ky sinjal ACE është përdorur si madhësi në dalje të sistemit të çdo zone gjeneruese të sistemit të fuqisë. Duke çuar ACE-të në të gjitha zonat drejt zeros, në këtë mënyrë do shkojë drejt zeros për të gjitha frekuencat dhe gabimet e fuqisë së eksportit të linjave të interkonjeksionit në sistemin e ndërlidhur të fuqisë [1].

## 2.6 Opërimi në paralel i sistemeve të ndërlidhura të fuqisë

Nëse një zone ka disa njësi gjeneruese të fuqisë që operojnë në paralel në të, për thjeshtësi do të trajtohet si një gjenerator ekuivalent.

Gjeneratori ekuivalent ka konstante e inercie ( $M_{eq}$ ), konstantia e rregullimit së ngarkesës ( $D_{eq}$ ) dhe përgjigje e karakteristikës frekuencës ( $B_{eq}$ ) mund të përfaqësohet si më poshtë.

$$M_{eq} = \sum_{i=1, \dots, n} M_i \quad (2.30)$$

$$D_{eq} = \sum_{i=1, \dots, n} D_i \quad (2.31)$$

$$B_{eq} = \sum_{i=1, \dots, n} \frac{1}{R_i} + \sum_{i=1, \dots, n} D_i \quad (2.32)$$

## 2.7 Modeli dinamik i një zone të njësive gjeneruese të fuqisë

Njësitë gjeneruese të sistemit të fuqisë dhe linjat e interkonjeksionit e zonave të ndërlidhura trajtohen në një formë e plotë e një zone të njësisë gjeneruese të sistemit të fuqisë mund të ndërtohet si Figurën 2.13.






Figura 2.13: Skema strukturore e një zone të njësisë gjeneruese të sistemit ndërlidhës të fuqisë

Në Figurën 2.13, kemi tre madhësi në hyrje, të cilat janë madhësia e variablit të kontrollit  $U(s)$ , ndryshimi i ngarkesës  $\Delta P_L(s)$ , dhe gabimi i fuqisë së shkëmbyer nga linja e interkonjeksionit  $\Delta P_{tie}(s)$ , madhësinë në dalje ACE  $Y(s)$ , dhe një gjenerator në dalje  $\Delta f$ . Tërmi  $\Delta P_e$  nuk është në figurën 2.13, sepse nuk ka një kuptim fizik. Vëmë re se madhësia në hyrje e njësisë ekuivalente në rregullatorin e shpejtësisë si  $\Delta P_e$ , për thjeshtësi kur zhvillojmë transformimin e Laplasit e një zone të sistemit gjenerues të fuqisë.

## 2.8 Modeli i transformimit të Laplasit i një zone të sistemit gjenerues të fuqisë

Konsiderojmë sistemin ashtu siç është treguar në Figurën 2.13. Marrëdhëniet midis madhësive në hyrje dhe në dalje në Figurën 2.13, mund të shkruhen si mëposhtë :

$$U(s) - \frac{\Delta F(s)}{R} = \Delta P_e(s) \quad (2.33)$$

$$G_{EU}(s) \cdot \Delta P_e(s) = \Delta P_v(s) \quad (2.34)$$

$$G_{Tur}(s) \cdot \Delta P_v(s) = \Delta P_m(s) \quad (2.35)$$

$$(\Delta P_m(s) - \Delta P_L(s) - \Delta P_{tie}(s)) \cdot G_{Gen}(s) = \Delta F(s) \quad (2.36)$$

$$Y(s) = B \cdot \Delta F(s) + \Delta P_{tie}(s) \quad (2.37)$$

ku :  $G_{EU}(s)$ ,  $G_{Tur}(s)$  dhe  $G_{Gen}(s)$  janë funksionet transmetuese për njësitë ekuivalente, turbinën dhe gjeneratorin respektivisht.

Për lehtësi të trajtimit të funksionit transmetues, lëmë funksionin transmetues nga  $\Delta P_e(s)$  që kemi përcaktuar në Figurën 2.13 shmangies së fuqisë mekanike  $\Delta P_m(s)$  të jetë :

$$G_{ET}(s) = \text{Num}_{ET}(s) / \text{Den}_{ET}(s)$$

ku:  $\text{Num}_{ET}(s)$  dhe  $\text{Den}_{ET}(s)$  janë numëruesi dhe emëruesi i funksionit  $G_{ET}(s)$  respektivisht.

Përfaqësimi i  $Num_{ET}(s)$  dhe  $Den_{ET}(s)$  mund të variojë nga njësi të ndryshme gjenëruese. Për njësinë e turbinës pa tëjnxehje, kombinimi i funksionit transmetues të njësisë ekuivalentë në rregullatorin e shpejtësisë  $G_{ET}(s)$  mund të shprehet si:

$$G_{ET}(s) = \frac{Num_{ET}(s)}{Den_{ET}(s)} = \frac{1}{(T_g s + 1) + (T_{ch} s + 1)} \quad (2.38)$$

Për njësinë e turbinës me tëjnxehje, funksioni transmetues do të jetë :

$$G_{ET}(s) = \frac{Num_{ET}(s)}{Den_{ET}(s)} = \frac{1}{(T_g s + 1) + (T_{ch} s + 1) + (T_{rh} s + 1)} \quad (2.39)$$

Për njësinë me turbinë hidraulike, funksioni transmetues jepet me shprehjenë e mëposhtme:

$$G_{ET}(s) = \frac{Num_{ET}(s)}{Den_{ET}(s)} = \frac{(T_R s + 1) \cdot (-T_w s + 1)}{(T_g s + 1) \cdot [T_R (R_T / R) s + 1] \cdot [(T_w / 2) s + 1]} \quad (2.40)$$

Funksioni transmetues i gjeneratorit ekuivalent të një zone të sistemit gjenërues të fuqisë jepet:

$$G_{Geb}(s) = \frac{1}{Den_M(s)} = \frac{1}{Ms + D} \quad (2.41)$$

ku:  $Den_M(s)$  paraqet emëruesin e  $G_{Gen}(s)$ .

Transformimi i Laplasit i një zone të sistemit gjenërues të fuqisë mund të thjeshtohet si mëposhtë:

$$Y(s) = G_P(s) \cdot U(s) + G_D(s) \cdot \Delta P_L(s) + G_{tie}(s) \cdot \Delta P_{tie}(s) \quad (2.42)$$

Ku

$$G_P(s) = \frac{RBNum_{ET}(s)}{Num_{ET}(s) + RDen_{ET}(s) \cdot Den_M(s)} \quad (2.43)$$

$$G_D(s) = \frac{-RBNum_{ET}(s)}{Num_{ET}(s) + RDen_{ET}(s) \cdot Den_M(s)} \quad (2.44)$$

$$G_P(s) = \frac{Num_{ET}(s) + RDen_{ET}(s) \cdot Den_M(s) - RDen_{ET}(s)}{Num_{ET}(s) + RDen_{ET}(s) \cdot Den_M(s)} \quad (2.45)$$

## 2.9 Modeli matematik i katër zonave të lidhur ne paralel

Rregullimi dytësor frekuencë - fuqi për një kohë të gjatë ka paraqitur një çështje shumë të rëndësishme në eksplotimin e sistemeve elektroenergjetike të ndërlidhura. Rregullimi frekuencë- fuqi duhet të mbaj drejtpeshimin në mes të energjisë së prodhuar dhe asaj të shpenzuar në një zonë kontrolli/ bllok të gjeneratorit. Dihet se rregullimi primar nënkupton veprimin spontan të rregullatorit të shpejtësisë të turbinës. Rregullimi parësor është i tipit statik me gabim stacionar të frekuencës, çka nënkuptojmë se pas paraqitjes së debalancit në mes të fuqisë së gjenëruar dhe asaj shpenzuar, frekuenca do të vendoset në një vlerë të ndryshme nga ajo nominale. Ky gabim stacionar jepet nëpërmjet koeficientit të vetë rregullimit, i cili mund të korigjohet vetëm me veprimin plotësues apo “sekondar” në hyrje të rregullatorit të turbinës. Rregullimi sekondar paraqet rregullim shtësë në rregullimin parësor, pas të cilit kemi një gabim të frekuencës, i cili me veprimin plotësues të rregullimit sekondar arrin të bëhet zero dhe frekuenca do të vendoset në vlerën nominale. Njësit gjenëruese të cilat marrin pjesë në rregullimin sekondar quhen njësi rregulluese.

Rregullimi sekondar frekuencë-fuqi realizohet me veprimin e përbashkët të të gjitha njësive rregulluese të cilat punojnë në paralelë në sistemin elektroenergjetik. Këto sisteme ndryshe quhen edhe zona e rregullimit (“Control area”). Në zonë kontrolluese bëhet ekuilibrimi në mes të fuqisë së shpenzuar dhe asaj të prodhuar. Në zonën rregulluese të gjithë gjeneratorët përbëjnë një grup në sinkronizëm, pra ka frekuencën e njëjtë në secilën pikë të sistemit pa marr parasysh gjendjen punuese, madhësinë e sistemit, pozitën dhe mënyrën e lidhjes së gjeneratorëve në mes veti. Rregullimi sekondar i një sistemi elektroenergjetik ose rregullimi fuqisë gjenëruese (“Automatic Generation Control”- AGC) ka dy qëllime: mbajtjen e frekuencës dhe shkëmbimit të fuqisë në linjat ndërlidhës në vlerat e programuara dhe kontrollimi i shpërndarjes së ngarkesa aktive në mes të njësive gjenëruese në punë. Rregullim frekuencë-fuqi me rregullimin e fuqive gjenëruese njihet edhe si “Load Frequency Control” (LFC), ndërsa kontrollimi i shpërndarjes së ngarkesa aktive njihet si dispeçing ekonomik apo “Economic Dispatch Control” (SDC).

Qëllimi i rregullimit frekuencë-fuqi (LFC) është mbajtja e bilancit energjetik në mes të fuqisë aktive të prodhuar dhe të shpenzuar në secilin sistem elektroenergjetik. Ky rregullim realizohet në kohë reale, si proces dinamik.

Shpërndarja e ngarkesës në mes të njësive gjenëruese (dispeçingu ekonomik) përcaktohet në bazë një kriteri ekonomik dhe është proces statik i cili realizohet në kohë reale. Qëllimi i kësaj është të bëhet shpërndarja e ngarkesës në mes të njësive prodhuese të një sistemi elektroenergjetik, duke i përmbushur kërkesat e konsumatoreve dhe me shpenzime minimale të prodhimit. Ky proces shpeshherë nënkupton “rregullimin tërciar”. Rregullimi tërciar realizohet duke marr parasysh shpenzimet e njësive gjenëruese dhe topologjinë e rrjetit, dhe në bazë të matjeve të fuqisë së dhënë llogaritët ngarkesa bazë ( $P_{01}$ ) dhe faktorët e pjesëmarrjes në mbulimin e ndryshimit të ngarkesës ( $v_1$ ) për secilën njësi ( $i = 1, 2, \dots, m$ ), në mënyrë që të realizohen shpenzimet më të ulëta të punës.

Sot përdoret rregullimi sekondar konvencional i tipit të decentralizuar duke kufizuar zonat individuale të sistemeve të ndërlidhura.

## 2.10 Rregullimi sekondar i sistemit elektroenergjetik të izoluar

Vetëm me rregullim parësor f-P, çdo ndryshim i ngarkesës në sistem do të silltë në regjim të vendosur një frekuencë të ndryshme nga nominalja për shkak të ekzistencës së një gabimi statik të ndryshëm nga zeroja, i cili mund të bëhet zero duke futur një nyje intëgruese rregullimin sekondar. Rregullimi sekondar realizohet me një urdhër plotësues në rregullatorin qendror (sekondar apo të rrjetit) që sillet në rregullatorët e turbinave nëpërmjet nyjës të hyrjes së sinjalit të jashtëm.

Rregullatori qendror i një zone rregulluese punon sipas ligjit:

$$w(t) = -k_{fp} \Delta f(t) - k_{fi} \int_0^t \Delta f(\tau) d\tau + w_0; \quad w(t_0 = 0) = w_0, \quad (2.46)$$

ku janë:  $w$  - sinjali në dalje të rregullatorit të rrjetit në nj.r.;

$k_{fp}$  – veprimi proporcional i rregullatorit të rrjetit në nj.r.;

$k_{fi}$  – veprimi integral i rregullatorit të rrjetit në nj.r. ( $1/k_{fi}$  është konstanta kohore e intëgrimit të rregullatorit të rrjetit në s);

$w_0$  – kushti fillestar ( në vazhdim do të supozohet se  $w_0=0$ ).

Sinjali në dalje të rregullatorit të rrjetit në njësi absolute i cili është  $W(t) = w(t)P_B$  (ku  $P_B = P_0$  është fuqia bazë në MW), na jep ndryshimin e fuqisë në sistem në MW që nevojitet për anulimin e sinjalit në hyrje pra devijimit të frekuencës  $\Delta F$ . Ky sinjal pastaj duhet të shpërndahet dhe të dërgohet në centralet për rregullim, pra duhet sjell në hyrje për sinjalin e jashtëm të rregullatorit të shpejtësisë të turbinës në agregatin për rregullim, si është treguar në bllok skemën e treguar në figurën 2.14.




Figura 2.14 Bllok skema e rregullimit të sistemit elektroenergjitik të izoluar ( me rregullim parësor, sekondar dhe terciar)

Në sistemin elektroenergjetik të rregulluar mund të dallohen këto grupe të agregatëve për gjenërim:

1. Turbogjenërorët të cilët marrin pjesë në rregullimin parësor me fuqi

$$P_{T1}^P, P_{T2}^P, \dots, P_{T1_p}^P; \quad P_T^P = \sum_{i=1}^{S_p} P_{Ti}^P. \quad (2.47)$$

2. Turbogjenërorët të cilët marrin pjesë në rregullimin sekondar me fuqi

$$P_{T1}^S, P_{T2}^S, \dots, P_{T1_p}^S; \quad P_T^S = \sum_{i=1}^{S_s} P_{Ti}^S. \quad (2.48)$$

3. Hidrogjenërorët të cilët marrin pjesë në rregullimin parësor me fuqi

$$P_{H1}^P, P_{H2}^P, \dots, P_{Hh_p}^P; \quad P_H^P = \sum_{j=1}^{h_p} P_{Hj}^P. \quad (2.49)$$

4. Hidrogjenërorët të cilët marrin pjesë në rregullimin sekondar me fuqi

$$P_{H1}^S, P_{H2}^S, \dots, P_{Hh_s}^S; \quad P_H^S = \sum_{j=1}^{h_s} P_{Hj}^S. \quad (2.50)$$

5. Hidrogjenërorët të cilët punojnë me hapje të kufizuar dhe turbogjenërorët me pajisjen e shkyçur për matjen e frekuencës me fuqi

$$P_{TL_1}, P_{TL_2}, \dots, P_{TL_S}; \quad P_{HL_1}, P_{HL_2}, \dots, P_{HL_h}; \quad P_L = \sum_{i=1}^{L_S} P_{TL_i} + \sum_{j=1}^{L_h} P_{TL_j}. \quad (2.51)$$

Fuqia e tërë në sistem është

$$P = P_T^P + P_T^S + P_H^P + P_H^S + P_L = P_T + P_H + P_L = P^P + P^S + P_L \quad (2.52)$$

ku është:

$$P_T = P_T^P + P_T^S; \quad P_H = P_H^P + P_H^S;$$

$$P^P = P_T^P + P_H^P; \quad P^S = P_T^S + P_H^S.$$

Faktorët e pjesëmarrjes në fuqinë e tërë të sistemit në gjendje stacionare për secilin grup të gjenërorëve janë:

$$\varepsilon_T^P = \frac{P_{T0}^P}{P_0}; \quad \varepsilon_H^P = \frac{P_{H0}^P}{P_0}; \quad \varepsilon^P = \varepsilon_T^P + \varepsilon_H^P;$$

$$\varepsilon_T^S = \frac{P_{T0}^S}{P_0}; \quad \varepsilon_H^S = \frac{P_{H0}^S}{P_0}; \quad \varepsilon^S = \varepsilon_T^S + \varepsilon_H^S;$$

$$\varepsilon_T = \varepsilon_T^P + \varepsilon_T^S; \quad \varepsilon_H = \varepsilon_H^P + \varepsilon_H^S; \quad \varepsilon_L = \frac{P_{L0}}{P_0}. \quad (2.53)$$

dhe

$$\varepsilon_T^P + \varepsilon_T^S + \varepsilon_H^P + \varepsilon_H^S + \varepsilon_L = \varepsilon_T + \varepsilon_H + \varepsilon_L = \varepsilon^P + \varepsilon^S + \varepsilon_L = 1,00.$$

Numri i gjenërorëve në prodhim në sistem është:

$$(s_P + s_S) + (h_P + h_S) + (L_S + L_h) = s + h + L = m. \quad (2.54)$$

Modeli i sistemit elektroenergjetik duhet të modifikohet për arsye të pesë grupeve të gjenërorëve. Kështu, duhet të shkruhen vektorët e gjëndjes, të rregullimit dhe të daljes dhe matricat e sistemit. Këto matrica dhe vektor për daljen  $y = b_s \Delta f$ , ku  $b_s$  është konstantia rregulluese e rregullatorit të rrjetit në nj.r., pra:

$$x = \begin{bmatrix} x_T^P \\ \dots \\ x_T^S \\ \dots \\ x_H^P \\ \dots \\ x_H^S \\ \dots \\ \Delta f \end{bmatrix}; \quad u = \begin{bmatrix} u_T^P \\ \dots \\ u_T^S \\ \dots \\ u_H^P \\ \dots \\ u_H^S \\ \dots \\ u_H \end{bmatrix}; \quad z = [\Delta p_L]; \quad y = b_s \Delta f$$

$$A = \begin{bmatrix} A_T^P & 0 & 0 & 0 & a_{ST}^P \\ 0 & A_T^S & 0 & 0 & a_{ST}^S \\ A_{HT}^{PP} & A_{HT}^{PS} & A_H^P & A_{HH}^{PS} & A_{HH}^P \\ A_{HT}^{SP} & A_{HT}^{SS} & A_{HH}^{SP} & A_H^S & A_{HH}^S \\ a_{TS}^P & a_{TS}^S & a_{HH}^P & a_{HH}^S & -\frac{e}{T} \end{bmatrix}; \quad \begin{aligned} e &= e_p - \sum_{i=1}^s e_{Ti} + \sum_{j=1}^s e_{Hj}; \\ s &= s_p + s_s; \\ h &= h_p + h_s; \end{aligned}$$

$$B = \begin{bmatrix} B_T^P & 0 & 0 & 0 \\ 0 & B_T^S & 0 & 0 \\ 0 & 0 & B_H^P & 0 \\ 0 & 0 & 0 & B_H^S \\ 0 & 0 & 0 & 0 \end{bmatrix}; \quad F = \begin{bmatrix} 0 \\ 0 \\ F_H^P \\ F_H^S \\ -\frac{1}{T} \end{bmatrix}; \quad C^T = \begin{bmatrix} 0 \\ 0 \\ 0 \\ 0 \\ b_s \end{bmatrix}. \quad (2.55)$$

Sinjali rregullues i rregullimit sekondar  $w(t)$ , do të shprehëndahet në gjenërorët rregullues në sistem varësisht nga elementët e vektorit të pjesëmarrjes  $v$  (i cili fitohet si produkt final i modulit të dispeçingut ekonomik), pra:

$$v^T = \begin{bmatrix} 0 \\ \dots \\ v_T \\ \dots \\ 0 \\ \dots \\ v_H \\ \dots \\ 0 \end{bmatrix}, \quad (2.56)$$

ku është  $v_T = [v_{T1} \ v_{T2} \ \dots \ v_{Ts_s}]^T$  - nënvektori i cili përkufizon pjesëmarrjen e turbogjenërorëve rregullues në rregullimin sekondar të sistemit;

$v_H = [v_{H1} \ v_{H2} \ \dots \ v_{Hh_s}]^T$  - nënvektori i cili përkufizon pjesëmarrjen e hidrogjenërorëve rregullues në rregullimin sekondar të sistemit;

Elementët dhe nënvektorët  $v_T$  dhe  $v_H$  duhet të plotësojnë relacionin

$$\sum_{i=1}^{s_s} v_{Ti} + \sum_{j=1}^{h_s} v_{Hj} = 1,00. \quad (2.57)$$

Sinjali rregullues i rregullimit sekondar  $w$  atëherë është:

$$w = u_T^S + u_H^S,$$

ku është:

$$\begin{aligned}
u_T^S &= \sum_{i=1}^{s_s} u_{T_i}^S = \sum_{i=1}^{s_s} v_{T_i} w; & u_{T_i}^S &= v_{T_i} w; \quad i=1,2,\dots,s_s; \\
u_H^S &= \sum_{j=1}^{h_s} u_{H_j}^S = \sum_{j=1}^{h_s} v_{H_j} w; & u_{H_j}^S &= v_{H_j} w; \quad j=1,2,\dots,h_s; \\
u_T^P &= 0; & u_{T_i}^P &= 0; \quad i=1,2,\dots,s_s; \\
u_H^P &= 0; & u_{H_j}^P &= 0; \quad j=1,2,\dots,h_s.
\end{aligned} \tag{2.58}$$

Vektori i rregullimit të rregullimit sekondar

$$u^s = [u_1 \quad u_2 \quad \dots \quad u_{m_s}]^T = [u_{T_1}^S \quad u_{T_2}^S \quad \dots \quad u_{T_{s_s}}^S \quad u_{H_1}^S \quad u_{H_2}^S \quad \dots \quad u_{H_{h_s}}^S]^T;$$

me dimensione  $m_s = s_s + h_s$ , me të cilin përkufizohen hyrjet rregulluese për secilin gjenëror rregullues, pra:

$$u(t) = v w(t), \tag{2.59}$$

Kështu, modeli i një sistemi të rregulluar në punë të izoluar do të jetë:

$$\begin{aligned}
\overset{o}{x}(t) &= Ax(t) + B v w(t) + Fz(t); & x(t_0) &= 0; \\
y(t) &= C^T x(t); \\
w(t) &= -k_p y(t) - k_I \int_0^t y(\tau) d\tau + w_0; & w(0) &= w_0 = 0,
\end{aligned} \tag{2.60}$$

dhe modeli i sistemit me lidhje me riveprim, është përkufizuar me ligjin (2.60):

$$\begin{aligned}
\begin{bmatrix} \overset{o}{x}(t) \\ 0 \\ w(t) \end{bmatrix} &= \begin{bmatrix} A & Bv \\ -k_p C^T A - k_I C^T & -k_p C^T Bv \end{bmatrix} \begin{bmatrix} x(t) \\ w(t) \end{bmatrix} + \begin{bmatrix} F \\ k_p C^T F \end{bmatrix} z(t); \\
\begin{bmatrix} x(0) \\ w(0) \end{bmatrix} &= \begin{bmatrix} 0 \\ 0 \end{bmatrix}; & u(t) &= v w(t).
\end{aligned} \tag{2.61}$$

Në figurën 2.15 është treguar bllok skema e sistemit elektroenergjetik të izoluar i cili përmban nga një gjenëror në secilin grup të dhënë me barazimet (2.47) deri në (2.54). Në këto modele nuk janë marrë parasysh modelet e mbartjes në largësi të sinjaleve të dirigjimit, ndërsa modelet e gjenërorëve janë paraqitur me funksionet transmetuese të rregullatorit



dhe turbinës. Në këtë model është marr dinamike e motorit për ndryshimin e shpejtësisë së rregullatorit të shpejtësisë të turbinës ( të cilët janë paraqitur si elementë Integrale me konstanten kohore  $T_H$ ). Të rregullatorit elektrik të turbinës dhe ky bllok mund të mos merret parasysh. Rregullimi tërciar, këtu është paraqitur nëpërmjet faktorit të shpërndarjes të sinjalit rregullues  $w(t)$  me koeficientët  $v_T$  dhe  $v_H$ , dhe rregullatori i rrjetit është treguar nëpërmjet funksionit transmetues  $w_{RrRr}(s)$ .




Figura 2.15 Bllok skema e sistemit elektroenergjetik me hidro-tërmo centrale që punon i izoluar me rregullim sekondar

## 2.11 Rregullimi sekondar i sistemit elektroenergjetik të ndërlidhur

Modeli i nxjerr me sipër për dy sisteme elektroenergjetike të ndërlidhura në domenin e gjëndjes zgjerohen duke i përkufizuar si ndryshore të daljes gabimet e secilit sistem të ndërlidhur, pra  $\Delta g_1$  ( apo ACE – Area Control Error). Kështu, modeli i sistemit do të jetë:

$$\begin{aligned} \dot{x}_1 &= A_1 x(t) + B_1 u(t) + F_1 z(t); \quad x(t_0) = 0; \\ y_1 &= \Delta g(t) = C^T x(t), \end{aligned} \quad (2.62)$$

ku vektorët dhe matricat e këtij modeli janë dhënë me relacionet:

$$x = \begin{bmatrix} x_1 \\ \Delta p_{12}^{(1)} \\ x_2 \end{bmatrix}; \quad u = \begin{bmatrix} u_1 \\ u_2 \end{bmatrix}; \quad z = \Delta g = (ACE) = \begin{bmatrix} \Delta g_1 \\ \Delta g_2 \end{bmatrix} = \begin{bmatrix} (ACE)_1 \\ (ACE)_2 \end{bmatrix};$$

$$A = \begin{bmatrix} A_1 & a_{12} & 0 \\ m_1^T & 0 & -m_2^T \\ 0 & -\alpha_{12} a_{21} & A_2 \end{bmatrix}; \quad B = \begin{bmatrix} B_1 & 0 \\ 0 & 0 \\ 0 & B_2 \end{bmatrix}; \quad , \quad F = \begin{bmatrix} F_1 & 0 \\ 0 & 0 \\ 0 & F_2 \end{bmatrix};$$

$$C^T = \begin{bmatrix} c_1^T & 1 & 0 \\ 0 & -\alpha_{12} & c_2^T \end{bmatrix}; \quad c_1^T = [0 \ 0 \ 0 \ 0 \ b_{s1}]; \\ c_2^T = [0 \ 0 \ 0 \ 0 \ b_{s2}];$$

$$\Delta g_1 = \Delta p_{12} + b_{s1} \Delta f_1; \quad \Delta g_2 = \Delta p_{21} + b_{s2} \Delta f_2 = -\alpha_{12} \Delta p_{12}^{(1)} + b_{s2} \Delta f_2 \quad (2.63)$$

Nënvektorët e variablave  $x_1, x_2, u_1, u_2, z_1, z_2$ , dhe nën matricat e sistemit  $A_1, A_2, B_1, B_2, F_1, F_2$  si dhe nënvektorët  $m_1^T, m_2^T$  për secilin sistem 1 dhe 2.

Ligji i rregullimit nga i cili nxirren sinjalet për rregullim  $w_1$  dhe  $w_2$  në secilin sistem të ndërlidhur është:

$$w(t) = -K_p y(t) - K_I \int_0^t u(\tau) d\tau + w_0 = -K_p C^T x(t) - K_I C^T \int_0^t x(\tau) d\tau + w_0;$$

$$w(t_0 = 0) = w_0 = 0 \quad (2.64)$$

ku është  $K_p = \begin{bmatrix} -k_{p1} & 0 \\ 0 & k_{p2} \end{bmatrix}$

- matrica e amplifikimeve proporcionale të rregullatorit të rrjetit të ndërlidhjes;

ku është  $K_I = \begin{bmatrix} k_{I1} & 0 \\ 0 & k_{I2} \end{bmatrix}$

- matrica e amplifikimeve integrale të rregullatorit të rrjetit të ndërlidhjes;




Figura 2.16 Bllok skema e rregullimit sekondar të dy sistemeve elektroenergjetike të ndërlidhur

Dhe vektori i udhëheqjes

$$w(t) = \begin{bmatrix} w_1(t) \\ w_2(t) \end{bmatrix} = \begin{bmatrix} -k_{p1}\Delta g_1(t) - k_{I1} \int_0^t \Delta g_1(\tau) d\tau \\ -k_{p2}\Delta g_2(t) - k_{I2} \int_0^t \Delta g_2(\tau) d\tau \end{bmatrix}, \begin{bmatrix} w_1(t_0=0) \\ w_2(t_0=0) \end{bmatrix} = \begin{bmatrix} 0 \\ 0 \end{bmatrix}, \quad (2.65)$$

ndërsa udhëheqja në secilin agregat përkufizohet me barazimet e ngjashme me barazimin (2.59), pra

$$u(t) = v w(t), \quad (2.66)$$

ku  $u$  është vektori i udhëheqjes në të dy sistemet e ndërlidhura, ndërsa

$$v = \begin{bmatrix} v_1 & 0 \\ 0 & v_2 \end{bmatrix} - \text{matrica e shpërndarjes së rregullimit sekondar,}$$

ku  $v_1$  dhe  $v_2$ , janë vektorët e pjesëmarrjes së njësisive të sistemit 1 dhe 2 në rregullimin sekondar.

Shprehjet (2.64) deri në (2.66) tregojnë se ligji udhëheqjes është i decentralizuar dhe rregullimin sekondar është i shpërndarë. Kjo nënkupton se rregullimi i një sistemi nuk varet nga ndryshimet në të dytin dhe anasjelltas. Kjo veçori e rregullimit sekondar konvencional është një prej karakteristikave shfrytëzuese më të rëndësishme.

Blok skema e rregullimit sekondar të dy sistemeve elektroenergjetike është treguar në figurën 2.16.

## 2.12 Përshtatja e parametrave dinamik të rregullatorit të rrjetit

*Rregullatori i rrjetit* ( i cili gjithashtu quhet edhe *rregullator sekondar*) është unik për tërë sistemin dhe është i vendosur në qendrën dispeçerike. Nga rregullatori i rrjetit kërkohet të anulohet gabimet e frekuencës dhe fuqisë së këmbimit, të cilat shkaktohen me ndryshimet e papritura të ngarkesës. Hyrja në rregullatorin e rrjetit është zgjedh sipas gabimit të frekuencës  $\Delta g = f_{ref} - f$ , ku  $f_{ref}$  është frekuenca “sekondare” apo referentë e cila zakonisht ka vlerën e frekuencës nominale, ndërsa  $f$  vlera e frekuencës së vërtetë ( e matur në vend të caktuar, ose vlera mesatare e nxjerr nga disa matje të kryera në pjesë të ndryshme të sistemit). Dalja nga rregullatori i rrjetit  $w$  ( quhet edhe shkalla e rregullatorit të rrjetit) dhe pastaj transmetohet në qendrën dispeçerike dhe fuqia referentë  $P_{ref}$  hynë në rregullatorin primar që të veprojë në fuqinë e njësisive përkatëse.

Kështu, rregullatori duhet të ketë veprim Integral, ndërsa veprimi proporcional dhe diferencial i shtohet për realizimin e karakteristikave dinamike të dëshiruara të sistemit. Në literaturë hasen shumë studime në të cilat përdoret logjika fuzzy dhe rrjetat artificiale neutrale për rregullimin frekuencë/fuqi. Kështu, përdorën rregullator të ndryshme si: rregullatorët PID

(8), rregullatorët me rrjeta artificiale neutrale (9), rregullatorët me logjikën fuzzy (10), rregullatorët PID fuzzy, rregullatorët me rrjeta dinamike fuzzy (7).




Figura 2.17 Bllok skema e rregullimit konvencional sekondar frekuencë/fuqi me rregullatorin e rrjetit proporcional plus integral (PI)

Për rregullatorin e tipit PI duhet të caktohen këta parametra: konstanta rregulluese  $b_s$ , koeficienti veprimit proporcional dhe Integral  $k_p$  dhe  $k_i$ . Bllok skema e rregullatorit proporcional plus Integral për rregullim frekuencë/fuqi është treguar në figurën 2.17.

Konstantia rregulluese  $b_s$  e rregullatorit të rrjetit paraqet faktorin për shndërrimin e ndryshimit të frekuencës në ndryshimin e fuqisë. Zakonisht kjo konstant barazohet me vlerën absolute të faktorit global të vetë rregullimit të sistemit ( i cili është përvetësuar se është negativ) që mundëson decentralizim të rregullimit të sistemeve të lidhura në nivele të zonave rregulluese. Nëse merret se  $b_s > |e_s|$ , atëherë mund të garantohet ndihma efikase e sistemit në të cilin ka ndodhur ngacmimi nga sistemet e tjera të ndërlidhura, gjatë vlerës së njëjtë të devijimit të frekuencës. Nëse merret se  $b_s < |e_s|$ , atëherë mund të garantohet zhvillim i përshatshëm i proceseve kalimtare, gjatë veprimit të rregullimit sekondar të kthimit të devijimit të frekuencës dhe fuqisë së këmbimit në zero. Secila vlerë pozitive për  $b_s$  garanton anulimin e devijimit të frekuencës dhe fuqisë së këmbimit, me kusht që sistemi në të cilin ka ndodhur ngacmimi të ka rezervë të mjaftueshme për kompensim. Nëse në sistemin “1” ka ndodhur ndryshimi i ngarkesës, atëherë vetëm në hyrje të rregullatorit sekondar të sistemit “1” do të vjen sinjali  $\Delta g_1 \neq 0$  dhe ky do të bëjë vetë kompensimin, ndërsa rregullatorët e sistemeve të tjera të ndërlidhura janë joaktiv.

Në sistemet komplekse të mëdha, mbajtja e frekuencës në vlerën nominale është shumë e mirë, dhe zgjedhja e konstantes rregulluese  $b_s$  nuk paraqet vështirësi. Anëtarin  $b_{s1} \Delta f_1$  në

shprehjen për  $\Delta g_1$  të dhëna në kapitullin 4.4. futët në rregullim fillimisht për të caktuar ndihmën reciproke në rast të ngacmimeve të mëdha në njërin prej sistemeve të lidhura në paralel, kur diapazoni rregullues i tij  $\Delta P_{r1}$  nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar deficitin/suficitin e fuqisë e paraqitur. Ndikimi i tij në rregullim, në shprehjen e gabimit të rregullimit  $\Delta g_1$ , në regjimin e punës normale, është i shumë i vogël në krahasim me ndikimin e anëtarit  $\Delta p_{e1}^{(1)}$ , sidomos kur fuqia e sistemeve veç e veç është shumë më e vogël se fuqia e ndërlidhjes.

Nëse supozohet se deficieti i fuqisë në sistemin “1” është  $\Delta P_1$ , dhe nëse ky sistem nuk ka rezervë të mjaftueshme për kompensim, atëherë ndryshimi i frekuencës të ndërlidhjes në regjimin stacionar në njësi absolute (Hz) është:

$$\Delta F = -\frac{\Delta P_1 - \left[ \frac{1}{2} \Delta P_{r1} - (P_1 - P_{10}) \right]}{|E_{s1}| + B_{s2} + B_{s3} + \dots + B_{s\ell}} = -\frac{\Delta P_{1Def}}{|E_{s1}| + B_{s2} + B_{s3} + \dots + B_{s\ell}} \quad (2.67)$$

ku është:

$P_1$  - ngarkesa e vërtetë e sistemit 1 në MW,

$P_{10}$  - ngarkesa bazë e sistemit 1 në MW, për të cilin është siguruar diapazoni rregullues  $\pm \frac{1}{2} \Delta P_{r1}$  (MW),

$\Delta P_{1Def}$  - deficieti i vërtetë i ngarkesa në sistemin 1, pas shfrytëzimit të rezervës rregulluese e cila është në dispozicion në MW.

Secili prej sistemeve fqinjë që punojnë në ndërlidhje, në gjendjen stacionare ofrojnë këtë ndihmë:

$$\Delta P_{ek} = -B_{sk} \Delta F_{ss} ; \quad k = 2, 3, \dots, \ell, \quad (2.68)$$

dhe ndihma e tërë të cilës ndërlidhja e jep në sistemin 1 në të cilin ka ndodhur ngacmimi është:

$$\Delta P_{e1} = \sum_{k=2}^{\ell} \Delta P_{ek} = \frac{B_{s2} + B_{s3} + \dots + B_{s\ell}}{|E_{s1}| + B_{s2} + B_{s3} + \dots + B_{s\ell}} \Delta P_{1Def} = \frac{\Delta P_{1Def}}{1 + \frac{|E_{s1}|}{\sum_{k=2}^{\ell} B_{sk}}} \quad (2.69)$$

Nëse nevojitet që ndihma e sistemit në të cilin ka ndodhur ngacmimi të jetë proporcional me fuqinë e tij, si kusht i nevojshëm është që vlerat e konstanteve  $B_{sk}$  të janë proporcionale me fuqitë e sistemeve përkatëse  $k = 2, 3, \dots, \ell$ , pasi që nga shprehja (2.69) kemi:

$$\frac{\Delta P_{e2}}{B_{s2}} = \frac{\Delta P_{e2}}{B_{s2}} = \dots = \frac{\Delta P_{e\ell}}{B_{s\ell}}, \quad (2.70a)$$

Nëse konstantes rregulluese zgjidhet në përpjesëtim me madhësinë e sistemit  $B_{sk} = aP_{k0}$  në nj.r. atëherë vlerat për  $b_{sk}$  janë të njëjta në të gjithë sistemet e ndërlidhura, çka nënkupton se të njëjta janë edhe vlerat relative të ndihmave, pra:

$$\Delta p_{e2}^{(2)} = \Delta p_{e3}^{(3)} = \dots = \Delta p_{e\ell}^{(\ell)} \quad (2.70b)$$

me këtë është përmbush kërkesa për përpjesëtimëri.

Faktori i përpjesëtimimit  $a = \frac{B_{sk}}{P_{k0}}$  varet edhe nga këta dy faktor:

- nga vlera maksimale e deficitit  $\Delta P_{1Def}$  për të cilën kërkohët ndihma nga sistemet fqinjë,
- nga kapacitetët mbartëse veç e veç dhe kapacitetin e tërë të linjave ndërlidhëse të veçanta  $(P_{0M} + \Delta P_M)_{ij}$ , përkatësisht kapacitet e tëra mbartëse të linjave ndërlidhëse  $(P_{e0M} + \Delta P_{eM})_k$  të sistemeve të veçanta  $(i, j, k = 1, 2, \dots, \ell; i \neq j)$ .

Në rastin e dy sistemeve të ndërlidhura këto kushtë shprehen me këto relacione:

$$\Delta P_{e1M} = \Delta P_{12M} \geq \frac{\Delta P_{1DefM}}{1 + \frac{|E_{s1}|}{B_{s2}}}; \quad \Delta P_{e2M} = \Delta P_{21M} \geq \frac{\Delta P_{2DefM}}{1 + \frac{|E_{s2}|}{B_{s1}}}; \quad \frac{B_{s1}}{P_{10}} = \frac{B_{s2}}{P_{20}} \quad (2.71)$$

Nga kemi:

$$B_{s1} = \frac{|E_{s2}|}{\frac{\Delta P_{2DefM}}{\Delta P_{12M}} - 1}; \quad B_{s2} = \frac{|E_{s1}|}{\frac{\Delta P_{1DefM}}{\Delta P_{21M}} - 1};$$

$$B_{s1} = \frac{P_{10}}{P_{20}} B_{s2} = \alpha_{12} B_{s2}; \quad \alpha_{12} = \frac{P_{10}}{P_{20}},$$

ose në njësi relative:

$$b_{s1} = \frac{\frac{|e_{s2}|}{\alpha_{12}}}{\frac{\Delta p_{2DefM}}{\alpha_{12} \Delta p_{12M}} - 1}; \quad b_{s2} = \frac{\alpha_{12} |e_{s1}|}{\frac{\alpha_{12} \Delta p_{1DefM}}{\Delta p_{21M}} - 1}; \quad b_{s1} = b_{s2}. \quad (2.72)$$

Mund të përfundohet se tarimi i konstantes rregulluese  $B_{sk} < |E_{sk}|$  mund të shkaktojë zhvendosje më të mëdha të energjisë së këmbimit nga vlera e kontraktuar, ndërsa tarimi  $B_{sk} > |E_{sk}|$  do të zvogëlohen ndryshimet e padëshirueshme të këmbimit, por do të rriten ndryshimet e frekuencës gjatë madhësive të njëjta të ngacmimeve (28). Gjithashtu për  $b_{sk}$  mund të merren vlerat në kufijtë  $(0.5-1.5)e_{sk}$ , ndërsa për  $k_p$  vlerat e rendit 0.1 nj.r. janë të mjaftueshme. Koeficienti i veprimit Integral të rregullatorit  $k_{Ik}$  duhet të tarohet në secilin rregullator të rrjetit në sistemet e ndërlidhura. Nuk është e dëshirueshme që rregullatorët të veprojnë për vlera të gabimit në hyrje, prandaj në këta rregullohet zona e jo ndjeshmërisë.

Gjatë kalimit nga një program i fuqisë së shkëmbimit në një tjetër, duhet të rregullohet edhe shpejtësia e ndryshimit të ngarkesës, në mënyrë që të pengohet shpejtësia e tëpruar e ndryshimit të fuqisë së agregatëve rregullues të cilën nuk kanë mundësi ta përcjellin. Rregullimi i shpejtësisë së ndryshimit (MW/min), duhet t'i përshtatët kërkesave që dalin nga diagrami i ngarkesës së sistemit dhe mundësive të centraleve me të cilat disponohet për rregullimit.

### 2.13 Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull diskutuam modelimin e secilës pjesë të njësive gjenëruese të sistemit të ndërlidhur të fuqisë, e ndjekur nga zhvillimi transformimit të Laplasit së zonës së decentralizuar gjenëruese të fuqisë. Objektivi i kontrollit të problemit të rregullimit frekuencë-fuqi është specifikuar për të drejtuar ACE në çdo zonë drejt zeros. Në këtë kapitull kemi hedhur bazat për projektimin dhe konstruktimin e rregullatorëve sekondare si dhe ndertimin e modelit të sistemit të fuqisë.



# KAPITULLI III

---

## RREGULLIMI FREKUENCË FUQI PËR SISTEMIN ME KATËR ZONA DUKE PËRDORUR RREGULLATORË TË NDRYSHËM

### 3.1 Hyrje

Sistemet e energjisë kanë karakteristika të ndryshme dhe të komplikuar dhe përfshijnë pjesë të ndryshme të kontrollit, shumë nga pjesët e të cilave janë jolineare. Këto pjesë janë të lidhura me njëra-tjetren me linja ndërlidhëse dhe kanë nevojë për kontrollin të frekuencës dhe fuqisë. Sistemet e ndërlidhura të energjisë me shumë zona mund të përshkruhen duke përdorur rrathë. Një sistem i thjeshtë i ndërlidhur me katër zona është dhe lidhja e sistemit elektroenergjetik shqipëtar me sistemet elektrike fqinjë si Greqia, Mal i Zi dhe me Kosoven i përdorur në këtë studim është paraqitur në figurën 3.1.




Figura 3.1 Lidhja me sistemet fqinjë të sistemit shqipëtar

Rregullimi frekuencë-fuqi në SE të Shqipërisë sot realizohet në mënyrë që në secilën zonë rregulluese janë të vendosura pajisjet në një vend i cili quhet qendër dispeçerike. Kjo qendër me sistemin elektroenergjetik është në lidhje të telemetrie, dhe informacioni nga rrjedhjet e fuqisë në linjat ndërlidhëse, sistemit të frekuencës dhe ngarkesat në MW dërgohen në këtë qendër në

të cilën veprimet e rregullimit janë të përqendruar në një kompjuter dixhital (regullatori dytësor). Për të zbatuar detyrat e sistemit të rregullimit frekuencë – fuqi (LFC), nga qendra e kontrollit kërkohën këto të dhena:

1. Fuqia e gjeneruar në megavat e secilën njësi që është në punë.
2. Fuqia në megavat që rrjedh nëpër linjat ndërlidhëse me sistemet fqinjë.
3. Sistemi i frekuencës

Sinjalet e rregullimit nëpërmjet kanaleve të njëjta transmetohen deri në njësitë gjeneruese (centralet) në AGC si është treguar në figurën 3.2. Zakonisht sot në praktikë transmetohen impulse rritëse/zbritëse me gjatësi të ndryshme deri në njësinë gjeneruese. Atëherë, në central pajisja për rregullim bënë lëvizjen e pikës së caktuar lartë apo poshtë në përpjesëtim me gjatësinë e impulsit.




Figura 3.2. Bllok skema e rregullimit frekuencë - fuqi për një Zone me  $n$  njësi rregulluese

Në figurën 3.3 është treguar zbatimi i AGC në sistemin elektrik shqiptar. Në sistemet e ndërlidhura secila zonë ka rregullimin në mënyrën e saj, por të varur nga rregullimi i zonave të tjera. Prandaj, edhe rregullimi automatik i gjenerimit në sistemin e ndërlidhur është i decentralizuar.




Figura 3.3. Bllok skema e rregullimit frekuencë - fuqi për sistemin e elektronergjetik shqiptar

Shumica e ndryshimeve në ACE janë për shkak të ndryshimeve të shpejta të rastësishme të ngarkesës në të cilat njësitë gjeneruese nuk duhet të reagojnë. Në fakt, veprimi i rregullimit në

reagimin në këto komponentë të rastësishme nuk do të dobësoj gabimin ACE por vetëm do të sjelle lëvizje të tëpërta duke shkaktuar konsumin e motorit të rregullatorit të shpejtësisë dhe valvulave të turbinës. Prandaj, programet AGC përdorin skemat për filtrim jashtë ndryshimeve të rastësishme, dhe gabimin e zbutur (SACE) përdoret për rregullim të gjenerimit. Në sinjalet AGC të përforcuar, duhet të jenë të njohur pasi këtu është kufiri i vlerës në të cilën prodhimi i njësive gjenëruese mund të ndryshohet. Kjo sidomos ka të bëjë me njësit tërmo në të cilat sforcimet mekanike dhe termike janë faktor kufizues. Vlera maksimale e ngarkesës për njësit gjenëruese tërmo është e rendit prej të 2% MCR (vlera maksimale e pandërprerë) për minutë. Për njësi gjenëruese hidro vlera është e rendit prej të 100% MCR për minutë.

Faktorët që ndikojnë në gjenërimin e fuqisë me kosto sa më të ulët janë: efikasiteti në punë, kosto e lëndës së parë dhe humbjet në transmetim. Shpërndarja optimale e gjenerimit duhet të trajtohet së bashku me strukturën e kontrollit të frekuencës. Në sistemet e kontrollit numerik, kompjutëri përfshihet në një të kontrollit e cila skanon njësitë gjenëruese si dhe flukset e fuqisë në linjat ndërlidhëse. Këto informacione krahasohen me të dhënat optimale të cilat derivojnë nga zgjedhja e programeve optimale të shpërndarjes së fuqisë. Në qoftë se të dhënat aktuale janë jashtë vlerave optimale, kompjutëri gjenëron impulse rritës/zbritës të cilat i dërgohen njësive gjenëruese individuale. Programi i shpërndarjes do të marrë gjithashtu parasysh edhe shkëmbimet në linjat ndërlidhëse midis zonave.

Regullatori duhet të marrë parasysh devijimin e frekuencës së sistemit  $\Delta f_i$ , derivimi në fluksin e fuqisë në linjën ndërlidhëse  $\Delta P_{tie}$ , çrregullimi (ngacmimi shqetësues) i ngarkesës  $\Delta P_{Di}$ . Vlerat e parametrave të sistemit janë dhënë në pjesën e mëposhtme. Modeli i sistemit mund të përshkruhet si:

$$\begin{aligned}\dot{x} &= Ax(t) + Bu(t) + Fw(t) \\ y(t) &= C^T x(t)\end{aligned}\quad (3.1)$$

ku B është matrica e kontrollit (përmbledh hyrjet e funksionit të kontrollit  $u$ ), F është matrica e ngacmimit shqetësues (përmbledh hyrjet funksionit të ngacmimit), C është matrica e daljes (përmbledh madhësitë e funksioneve në dalje, të cilat janë edhe hyrjet në rregullatorin dytësor) dhe A është matrica e gjëndjes.

$$\begin{aligned}x &= [\Delta f_1 \quad \Delta P_{t1} \quad \Delta P_{g1} \quad \Delta P_{tie-1} \quad \dots \quad \Delta f_m \quad \Delta P_{tm} \quad \Delta P_{gm} \quad \Delta P_{tie-m}]^T \\ u_1 &= [\Delta P_{C1}] \\ y_1 &= B_1 \Delta f_1 + \Delta P_{tie-1}\end{aligned}\quad (3.2)$$

Kështu për rastin me katër zona do të kishim:

$$\begin{aligned}x &= [\Delta f_1 \quad \Delta P_{t1} \quad \Delta P_{g1} \quad \Delta P_{tie-1} \quad \Delta f_2 \quad \Delta P_{t2} \quad \Delta P_{g2} \quad \Delta P_{tie-2} \quad \Delta f_3 \quad \Delta P_{t3} \quad \Delta P_{g3} \quad \Delta P_{tie-3} \quad \Delta f_4 \quad \Delta P_{t4} \quad \Delta P_{g4} \quad \Delta P_{tie-4}]^T \\ u &= [u_1 \quad u_2 \quad u_3 \quad u_4]^T \\ w &= [\Delta P_{d1} \quad \Delta P_{d2} \quad \Delta P_{d3} \quad \Delta P_{d4}]^T \\ y &= [y_1 \quad y_2 \quad y_3 \quad y_4]^T\end{aligned}\quad (3.3)$$

$$\begin{aligned}
\Delta P_1(k) &= \Delta P_{12}(k) + \alpha_{41} \Delta P_{41}(k) \\
\Delta P_2(k) &= \Delta P_{23}(k) + \alpha_{12} \Delta P_{12}(k) \\
\Delta P_3(k) &= \Delta P_{34}(k) + \alpha_{23} \Delta P_{23}(k) \\
\Delta P_4(k) &= \Delta P_{41}(k) + \alpha_{34} \Delta P_{34}(k)
\end{aligned}
\tag{3.4}$$

Kontrolli i ndikimit të linjave ndërlidhëse përdoret për të eliminuar devijimin e frekencës në fluksin e linjës ndërlidhëse. Kjo bazohet në faktin se cdo zonë kontrolli, përveçse duhet të bëjë rregullimin parësor frekuencë – fuqi brenda zonës, duhet të kontribuojë edhe në rregullimin sekondar. Nëse shënojmë:

$ACE_1$  – kontrolli i gabimit të zonës së parë

$ACE_2$  – kontrolli i gabimit të zonës së dytë

$ACE_3$  – kontrolli i gabimit të zonës së tretë

$ACE_4$  – kontrolli i gabimit të zonës së katërt

atëhere ato do jenë kombinime lineare të devijimit të frekuencës dhe devijimit të fuqisë në linjat ndërlidhëse, përkatësisht:

$$\begin{aligned}
ACE_1 &= \Delta P_{14} + b_1 \Delta f_1 \\
ACE_2 &= \Delta P_{23} + \Delta P_{24} + b_2 \Delta f_2 \\
ACE_3 &= \Delta P_{34} + \Delta P_{32} + b_3 \Delta f_3 \\
ACE_4 &= \Delta P_{41} + \Delta P_{42} + \Delta P_{43} + b_4 \Delta f_4
\end{aligned}
\tag{3.5}$$

ku  $b_1, b_2, b_3, b_4$  janë përkatësisht faktorët e ndikimit të zonës 1, zonës 2, zonës 3 dhe zonës 4.

## 3.2 Vlerësimi i cilësisë së rregullimit të rregullatorit sekondar

### 3.2.1 Kriteret themelore

Me efektshmëri (përformancë) të sistemit rregullimit automatik sekondar, nënkuptohet vlerësimi i cilësisë së funksionimit të këtij sistemi, duke marrë parasysh rolin dhe detyrat e parashtruara të rregullimit[1].

Për vlerësimin e cilësisë janë të domosdoshëm disa kriteret, udhëzime të punës dhe mjetet për analizë. Për këto qëllime, sistemet e mëdha ndërlidhëse (ENTSO, NERC, etj.) kanë aprovuar kriteret për performanca dhe kanë dhënë udhëzimet për punë [39]. Nga këto më të njohura janë udhëzimet për punë të dhe kriteret e performancave të Këshillit Nacional të Amerikës për besueshmërinë e punës së sistemit elektroenergjetik (NERC). Këto kriteret të performancave bazohen në kërkesën themelore për shfrytëzimin e rezervës së punës, e cila duhet të shfrytëzohet në mënyrë efektive në periudhën prej 10 minutave. Rezerva e punës përbëhet nga rezerva e avarisë ( e destinuar për mbulim e rënies së njësisë më të madhe në sistem) dhe rezervës rregulluese ( me ndihmën e së cilës korrigjohen gabimet në parashikim e ngarkesës). Kështu, secila zonë rregulluese duhet të jetë e aftë që këtë ribalancë në mes prodhimit dhe ngarkesës dhe ta korrigjojë brenda afatit prej 10 minutash. Kjo kërkesë është marrë si bazë nga e cila janë nxjerr këto kriteret të performancave, për regjimin e punës normal (A) dhe regjimin e punës me ngacmim (B):

- A1. Gabimi i rregullimit të sistemit, në të gjitha intervalet 10 minutëshe të punës, duhet të jetë së paku një herë e barabartë me zero;
- A2. Vlera mesatare e gabimi të rregullimit të sistemeve veç e veç për të gjitha intervalet 10 minutëshe gjatë një ore, duhet të jetë në brenda intervalit të paraparë me dispozita. Kufijtë e këtij intervali caktohen në bazë të shpejtësisë njëorëshe më të madhe të mundshme të ndryshimit të ngarkesës e zonës rregulluese, pra:

$$\Delta G_i^M = 5 + 0.025 \Delta P_i^M ; \quad i = 1, 2, \dots, \ell \quad (3.6)$$

ku  $\Delta P_i^M$  ndryshimi më i madh njëorësh ( rritja/zvogëlimi) i ngarkesës së zonës rregulluese “ 1 “, në ditën e ngarkesës maksimale vjetore;

- B1. Në kushtet e ngacmimit i cili do të sjell disbalancën e fuqive, gabimi rregullues i sistemit duhet të kthehet në zero në afatin prej 10 minutave;
- B2. Veprimi korrigjues i rregullimit sekondar duhet të fillojë jo më vonë së 60s pas paraqitjes së ngacmimit. Gjithashtu, merret se ngacmimi ka ndodh nëse vlera momentale e gabimit rregullues të sistemit  $\Delta G_i(t)$  të kalojë kufirin prej  $3\Delta G_i(t)$ .

### 3.2.2 Kërkesat e veçanta dhe kriteret që lidhen me proceset e ndryshueshme të rregullimit automatik sekondar

Kriteret që lidhen me proceset e ndryshme të rregullimit automatik sekondar janë: frekuenca, fuqitë e këmbimit, gabimi rregullimit të sistemit dhe funksionimi i agregatëve rregullues, të cilat do të analizohen në vijim.

Frekuenca. Frekuenca, si një ndryshore e vazhdueshme e rastit, në kushtë normale të punës përcaktohet me vlerën mesatare:  $M(F) = F_{mes}$ , e cila duhet të jetë e barabartë me frekuencën nominale, dhe devijimi i mesëm katror për këtë vlerë mesatare dhe që jepen me shprehjet:

$$M(F) = \frac{1}{T} \int_0^T F(t) dt = F_{mes} ;$$
$$\sigma_{\Delta F} = \sqrt{\frac{1}{T} \int_0^T (F(t) - F_{mes})^2 dt} = \sqrt{\frac{1}{T} \int_0^T (\Delta F(t))^2 dt} \quad (3.7)$$

ku T është interвали kohor i vështruar.

Për periudhat e punës pas ngacmimeve të mëdha, mbajtja e frekuencës nuk mund të përcaktohet me treguesit e dhënë me (3.7), por duhet të vëzhgohet numri, amplituda dhe zgjatja e devijimeve të frekuencës të shkaktuara nga ky ngacmim.

Devijimi i frekuencës për  $\pm 0.1 Hz$  në krahasim me frekuencën nominale për shumicën e konsumatoreve të energjisë elektrike është i pranueshëm. Nëse marrin në konsideratë shpërndarjen e Gausit të paraqitjes së devijimeve të papritura të frekuencës, ku gjasat e paraqitjes së devijimeve më të mëdha të cilat e tejkalojnë devijimin e mesëm katror janë të vogla. Prandaj, mund të konstatohet se ky kusht mund të plotësohet nëse devijimet standarde  $\sigma_{\Delta F}$  janë më të vogla se  $\pm 0.1 Hz$ , që është rasti i punës në kushtë normale të sistemeve elektroenergjetike të mesme dhe të mëdha (30). Ndërsa gjatë ngacmimeve të mëdha në sistem, rëniet e frekuencës mund të janë (1-2Hz), të cilat shkaktojnë rritjen e fuqisë prodhuese të centraleve, për eliminim e këtyre devijimeve. Të gjitha këto devijime të frekuencës, shkaktojnë reagimin e rregullatorit të shpejtësisë së turbinës dhe si pasojë e kësaj kemi rishpërndarjen e ngarkesës në sistem. Prandaj, mbajtja e frekuencës nominale është faktor që vënë një rend në eksplotimin e sistemit elektroenergjetik, dhe është kërkesë e shpenzuesve të energjisë elektrike.

Fuqia e këmbimit. Në çdo sistem elektroenergjetik, disbalanca që paraqitet në mes të fuqisë së prodhuar dhe asaj të shpenzuar, do të shkaktoj ndryshimet e fuqive të këmbimit në krahasim me programin e miratuar të këtij këmbimin në mes të sistemeve të ndërlidhura. Ngjashëm si ndryshimet e ngarkesës, edhe ndryshimet e fuqisë së këmbimit mund të kategorizohen në ndryshime të shpejta dhe të ngadalshme.

Sistemi i rregullimit automatik sekondar ka për detyrë që të kompensojë ndryshimet e ngadalshme të fuqisë së këmbimit dhe vlerën mesatare të saj ta mbaj në programin e përcaktuar

me kontratë në mes të partnerëve që këmbajnë energjinë. Si tregues që karakterizojnë mbajtjen e fuqisë së këmbimit, përveç vlerës mesatare  $M(P_{ij}) = (P_{ij})_{mes}$  e cila duhet të mbahet në vlerën e programuar, merret edhe devijimi i mesëm katror i llogaritur nga vlerat mesatare të fuqisë së këmbimit ( $\sigma_{\Delta \bar{P}_{ij}}$ ) në intervalet të cilët janë më të shkurtër se konstanta termike e linjës (e cila është e rendit 10-15min). Këta tregues jepen me shprehjet:

$$M(P_{ij}) = \frac{1}{T} \int_0^T P_{ij}(\tau) d\tau$$

$$\sigma_{\Delta \bar{P}_{ij}} = \sqrt{\frac{1}{T} \int_0^T (P_{ij0} - \bar{P}_{ij}(\tau))^2 d\tau} = \sqrt{\frac{1}{T} \int_0^T (P_{ij0}(\tau))^2 d\tau} = \sqrt{\frac{1}{n} \sum_{k=1}^n (\Delta \bar{P}_{ij}(\tau))^2 d\tau}; \quad (3.8)$$

ku është:

$$\Delta \bar{P}_{ij} = \frac{1}{T_1} \int_0^{T_1} (P_{ij0} - \bar{P}_{ij}(\tau)) d\tau$$

$$T = \sum_{k=1}^n T_{1k}$$

vlerat mesatare e vlera devijimit të fuqisë së këmbimit në raport me programin në intervalin kohor  $T_1$  ( i cili ka n, dhe gjatësia e tyre merret rreth 5 minuta);

Kushtet fillestare në bazë të së cilëve nxirren kriteret e performancës së sistemit për rregullimin automatik sekondar, mund të fitohen duke marr një vlerë të caktuar të devijimit të mesëm katror  $\sigma_{\Delta \bar{P}_{ij}}$  ( që del nga marrëveshja e përbashkët e partnerëve të cilët punojnë paralel).

Gabimi i rregullimit të sistemit. Kërkesa themelore që parashtrohet në lidhje me gabimin i rregullimit është kompensimi i ndryshimit vetjak të ngarkesës brenda secilit sistem elektroenergjetik të ndërlidhur. Për këtë qëllim duhet të përkufizohet se me çfarë saktësie dhe në cilët kufij të tolerancës duhet të bëhet ky kompensim në secilin sistem elektroenergjetik të ndërlidhur.

Gabimi i rregullimit është ndryshore e rastit dhe karakterizohet me tregues statistikor të njëjtë si fuqia e këmbimit, pra:

$$M(\Delta G_i) = \frac{1}{T} \int_0^T G_i(\tau) d\tau$$

-vlera mesatare e gabimit të rregullimit të sistemit “i”, i cili duhet të jetë  $M(\Delta G_i) = 0$ ;

$$\sigma_{\Delta \bar{P}_{ij}} = \sqrt{\frac{1}{T} \int_0^T (\Delta G_i(\tau))^2 d\tau} = \sqrt{\frac{1}{n} \sum_{k=1}^n (\Delta \bar{G}_i(\tau))_k^2 d\tau} \quad - \text{devijimi i mesëm katror e gabimit të}$$

rregullimit të sistemit “i”, i llogaritur nëpërmjet vlerave mesatare të devijimit në n intervale

$$\text{me kohëzgjatje } T_1 = \frac{T}{n} \approx 5 \text{ min}; \quad \Delta \bar{G}_i = \sum_{\substack{j=1 \\ j \neq i}}^m \Delta \bar{P}_{ij} + B_{si} \Delta \bar{F}$$

Vlera mesatare e gabimit të rregullimit të sistemit “i”, e llogaritur nëpërmjet vlerave mesatare të frekuencës dhe fuqisë së këmbimit në intervalet kohore:

$$T_1 = \frac{T}{n} \quad (3.9)$$

Në të gjitha sistemet elektroenergjetike të ndërlidhura lakoret ditore të ngarkesës kanë formën e ngjashme, prandaj supozohet se edhe gabimet e rregullimit duhet të janë proporcionale me fuqitë maksimale të tyre, ndërsa ndihma që ndërmjet sistemeve në rast të ndonjë prishje në ndonjërin prej tyre duhet të jetë e njëjtë. Në rastin e sistemit të pajisur me rregullim automatik sekondar, kushti i fundit do të jetë:

$$\frac{\Delta \bar{G}_1}{B_{s1}} = \frac{\Delta \bar{G}_2}{B_{s2}} = \dots = \frac{\Delta \bar{G}_n}{B_{sn}} \quad (3.10)$$

ky kusht do të plotësohet nëse konstantet e rregullimit  $B_{s1}$  e rregullatorëve të rrjetit përzgjidhen në përpjesëtim me fuqitë përkatëse të sistemeve. Në pikëpamje statistike kushti (4.10) mund të reduktohet:

$$\frac{\sigma_{\Delta \bar{G}_1}}{B_{s1}} = \frac{\sigma_{\Delta \bar{G}_2}}{B_{s2}} = \dots = \frac{\sigma_{\Delta \bar{G}_n}}{B_{sn}} \quad (3.11)$$

Funksionimi i agregatit rregullues. Agregatët rregullues sipas urdhrit të cilin e merr nga rregullatori i rrjetit, bëjnë ndryshimin e fuqisë së prodhuar brenda intervalit të rregullimit. Mirëpo, personeli në centralë e kushtëzon kufizime në pikëpamje të amplitudës, shpejtësisë dhe frekuencës së ndryshimit të fuqisë së prodhuar të agregatit rregullues, për shkak të natyrës teknike dhe ekonomike. Kusht themelor për të minimizuar efektët e këtyre kufizimeve është që në rregullimin sekondar të marrin pjesë një numër i madh i agregatëve. Si treguesit më të përshtatshëm për të treguar funksionimin e agregatëve rregullues janë këtë madhësi:

a. puna rregulluese:

$$W_r = \int_0^T |P_a(\tau) - P_B| d\tau; \quad (3.12)$$

b. fuqia mesatare e rregullimit:

$$W_r = \frac{1}{T} \int_0^T |P_a(\tau) - P_B| d\tau = \frac{W_r}{T}; \quad (3.13)$$

c. devijimi i mesatares kuadratike të fuqisë së rregullimit:



$$\sigma_{\Delta P_r} = \sqrt{\frac{1}{T} \int_0^T (P_a(\tau) - P_B)^2 d\tau}; \quad (3.14)$$

d. shpejtësia mesatare e ndryshimit të ngarkesës të agregatit rregullues:

$$V_p = \frac{1}{T} \int_0^T \left| \frac{dP_a}{d\tau} \right| d\tau; \quad (3.41)$$

e. vlera mesatare kuadratike e shpejtësisë së ndryshimit të ngarkesës së agregatit rregullues:

$$\sigma_v = \sqrt{\frac{1}{T} \int_0^T \left( \frac{dP_a}{d\tau} \right)^2 d\tau}. \quad (3.15)$$

ku  $P_a$  është fuqia prodhuese e vërtetë, ndërsa  $P_b = P_0$  fuqia bazë e agregatit rregullues.

### 3.2.3 Kërkesat dhe kriteret që lidhen me analizën e procesit të rregullimit automatik sekondar

Analiza kalimtare (tranzientë). Duke u bazuar në lakoren e ndryshimit në kohë të gabimit të rregullimit Figurën 3.4, pas ndryshimit shkallë të ngarkesës në ndonjë sistem elektroenergjetik të ndërlidhur, stabiliteti i sistemit dhe dinamika e saktësisë mund të vlerësohen nga forma e lakores në gjendjen kalimtare, ndërsa saktësia statike sipas gabimit të mbetur pas kalimit të gjëndjes kalimtare.




Figura 3.4. Përgjigjia kalimtare e ndryshimit të gabimit të rregullimit pas ndryshimit shkallë të ngarkesës në sistem.

Të gjitha këto vlerësohen nga këta tregues:

- ordinatën e maksimumit të parë  $\Delta G_m$  (kërcimin), pas ndryshimit me kërcim të amplitudës në hyrje. Kjo preferohet të shprehet në varësi nga ndryshimi  $\Delta G_{\infty}^{NR} = \Delta D$  në gjendjen stacionare, e cila do të fitohet me ngacmimin e njëjtë në sistemin pa rregullim automatik;

- kohën që kalon deri të paraqitja e maksimumit të parë  $T_1$ ;
- kohën e qetësimit  $T_{95}$ , të nevojshme për kompensimin e 95% të gabimit të rregullimit  $\Delta G(t)$ , të shkaktuar nga ndryshimi i madh i ngarkesës;
- gabimi statik  $\Delta G_\infty$ ;
- Integralin e katrorit të gabimit të rregullimit ( nëse gjatë punës së rregullimit automatik sekondar)  $\Delta G_\infty \rightarrow 0$ ;

$$\psi_G = \int_0^{\infty} [\Delta G(\tau)]^2 d\tau \quad (3.16)$$

Analiza statike. Për caktimin e cilësisë së rregullimit sekondar, nëse si kusht i vetëm është përfitimi i rregullimit më të mirë të frekuencës dhe fuqisë së këmbimit, atëherë duhet të marrin kriterin e minimizimit të Integralit të katrorit të mesatares të gabimit të rregullimit. Gjithashtu duhet të merret parasysh se rregullimi mund të përmirësohet vetëm me rritjen e punës rregulluese të agregatëve që janë në prodhim në sistem. Kompromisi në mes të këtyre dy kriterëve zgjidhet me aplikimin e metodës për optimizimin me kusht, çka nënkupton minimizimin e mesatares kuadratike të gabimit të rregullimit  $\bar{\psi}_G$  duke supozuar se puna rregulluese e agregatëve veç e veç dhe e tërë sistemit elektroenergjetik nuk kalon vlerat e dhëna. Nëse merret vlera mesatare e gabimit të rregullimit e llogaritur për intervale kohore me kohëzgjatje prej 5 minuta, atëherë kriteri i minimizimit të mesatares kuadratike të gabimit të rregullimit është:

$$\bar{\psi}_G = \lim_{T \rightarrow \infty} \int_0^T [\Delta \bar{G}(\tau)]^2 d\tau = Min \quad (3.17)$$

### 3.3 Rregullimi frekuencë-fuqi me rregullator PID

Ne këtë pjesë do të trajtojmë rregullimin dytësor të frekuencës duke përdorur si rregullator dytësor të ACE rregullatorin PID. Ne Kapitullin I u përmenden disa literatura të cilat sistemet elektrike të fuqisë përdorin si rregullator dytës tipe të ndryshem një nga rregullatorët që ka gjetur përdorim të gjerë është dhe rregullatori i tipi PID. Megjithatë, përshtatja e algoritmeve të përmirësuara të kontrollit ka qenë e ngadalshme. Shumë zbatime të kontrollit kompjuterik kanë marrë thjesht algoritmin analog të kontrollit të njohur si (proporcional + integral + derivat - PID). Modeli matematik në formën e përgjithshme jepet me shprehjen si me poshtë. Ndërsa në figurën 3.5: jepe skema strukturore e rregullatorit PID të propozuar.

$$G_{RR} = K_p + \frac{K_I}{s} + sK_D \quad (3.18)$$

Ku:  $K_p$ ,  $K_I$ ,  $K_D$  janë koeficientët përkatësisht proporcional, Integral dhe derivat.




Figura.3.5 Bllok skema e rregullatorit PID

Për përcaktimin e koeficientëve të rregullatorit PID të propozuar është përdorur metoda si më poshtë. Përcaktimi i koeficientave të rregullatorit PID nga mënyrat e kombinimit të tij mund të ndahet në 3 hapa.

**Hapi 1:** Fiksojmë një  $K_p$  e cila rezulton në një numër të lartë të lëkundjeve të përgjigjes kalimtare ndërkohë që  $K_I$  dhe  $K_D$  pranohen zero. Koeficienti proporcional ndikon në lëkundjet e përgjigjes kalimtare. Një vlerë e  $K_p$  e madhe sjell zvogelimin e kohëzgjatjes së përgjigjes kalimtare dhe në uljen e gabimit në gjëndjen e stabilizuar, por kjo sjell rritjen e lëkundjeve të përgjigjes kalimtare. Një  $K_p$  e lartë mund të përdoret në sistemet e kontrollit që kanë vetëm një hyrje një dalje. Ndërsa në sistemet me shumë hyrje shumë dalje, nëse  $K_p$  është e lartë do jetë shumë e nderlikuar puna e lëkundjeve të sistemit. Prandaj zgjedhja e  $K_p$  rezulton që të dërgoje sistemin afër kufirit të qendrueshmerise.

**Hapi 2:** Duke përdorur koeficientin e derivimit mund të zvogeloje lëkundjet e përgjigjes kalimtare duke parandaluar kështu një dalje nga qëndrueshmeria e sistemit. Zgjedhja e  $K_D$  është e rëndesishme sepse rezulton në zgjidhjen e kohëzgjatjes së përgjigjes kalimtare dhe në vlerën e mbirregullimit. Kjo mund të arrihet duke bërë një kombinim të variacioneve të  $K_D$  dhe  $K_p$  që përcaktuar në hapin e parë dhe me pas analizojmë përgjigjen në simulink. Pra deri tani kemi gjetur  $K_p$ ,  $K_D$ , ndërsa  $K_I$  është zero.

**Hapi 3:** Deri tani jemi kujdesur për lëkundjet e sistemit. Tani do përqendrohemi në gabimin e gjendjen e stabilizuar. Nëse ky gabim nuk është zero, pasi në hapin 2 kemi përcaktuar  $K_p$  dhe  $K_D$  do ndryshojmë  $K_I$  në mënyrë që të gjejmë një  $K_I$  që ta bëjë këtë gabim zero për një kohë sa më të shkurtër. Kështu funksionon një rregullator PID. Por ka rastë që nuk na kërkohet hapi i dytë ose i tretë sepse në rastë të ndryshme mund të jetë e mjaftueshme përdorimi i një rregullatorit PI, PD. Në bazë të rregullave të mesipërme kemi përcaktuar të koeficientët e rregullatorit PID për secilën zone kontrolli si në Tabelen 3.1.

Tabela 3.1. Koeficientët e rregullatorit PID të propozuar.

Koeficienti	Area 1 (Greqia)	Area 2 (Kosova)	Area 3 (Mali i Zi)	Area 4 (Shqipëria)
$K_p$	0.1109	0.0121	0.210	0.14
$K_i$	0.213	0.205	0.450	0.310
$K_d$	0.112	0.095	0.351	0.264

### 3.4 Rregullimi frekuencë-fuqi me rregullator Fuzzy

Rregullatori i sistemit të rregullimit fuqi frekuencës, përgjithësisht përbëhet nga rregullator konvencionale siç është, rregullatori Integral dhe rregullatori proporcional Integral (PI). Edhe duke përdorur këta rregullatorë në sisteme të ndërlidhura, performanca e sistemit nuk është mjaft e mirë. Me fjalë të tjera, këto rregullatorë janë statike dhe nuk janë më të përshtatshëm për ndryshimin e shpejta të ngarkesës. Kur numri i zonave të ndërlidhura është gjithnjë e më shumë dhe duke futur jo-linearitetë, situata përkeqësohet. Në këto rrethana, rregullatori i rregullimit fuqi frekuencë i bazuar në logjikën Fuzzy është propozuar për kontrollin dhe operimin e sigurtë të sistemit të fuqisë. Projektimi i rregullatorit të sistemit frekuencë-fuqi i bazuar në logjikën Fuzzy përbehet nga tre faza, fuzzifikimi, rregullat bazë dhe defuzzifikimi. Në këtë punim një rregullator sioas logjikës Fuzzy është zhvilluar dhe propozuar për sistemin me katër zona.

### 3.5 Sinteza e Rregullatorit Fuzzy

Logjika Fuzzy e ka origjinën si logjikë e konceptëve “e saktë” ose “e gabuar”. Metoda e fuzzifikimit ka gjetur aplikime në rritje në sistemet e fuqisë. Aplikimet e grupeve fuzzy nënkuptojnë një përmirësim të madh të analizës dhe kontrollit së sistemit fuqisë duke shmangur supozimet e linearizimit në rastë praktike. Kjo për shkak se elementët jolineare mund të modelohen si lineare duke u shmangur shumë dhe realiteti duke sjelle dhe modelim të pa saktë të sistemit të fuqisë.

Koncepti i Logjikës Fuzzy (FL) u zhvillua nga Zadeh në 1965 për të adresuar pasigurinë dhe pasaktësinë (Zadeh 1965) e cila ekziston gjerësisht në problemet inxhinierike. Qasja e procesit të tij theksoi pasiguritë e modelimit që lindin zakonisht në proceset e mendimit njëjërëzor. Sistemi i kontrollit fuzzy normalisht është i ndarë në: planifikim të fitimit fuzzy (fuzzy gain scheduling) dhe rregullator logjik fuzzy. Teknika e mëparshme zakonisht përdoret për të gjetur vlerën optimale të rregullatorëve, kjo e fundit është më e dobishmja për problemet praktike. Në këtë punim është adoptuar kontrolluesi i logjikës fuzzy për sistemin e rregullimit fuqi frekuencë.

#### 3.5.1 Komponentët e Sistemit Fuzzy

Projektimi i rregullatorit sipa logjikës Fuzzy mund të ndahet në tre faza: fuzzifikimi, baza e rregullave dhe defuzzifikimi. Në modelin e sistemit fuzzy, ekzistojnë dy sisteme themelore të inferenzës logjikës fuzzy: tipi Mamdani dhe tipi Sugeno. Inferenza e tipit Mamdani parashikon që daljet të jenë bashkësi fuzzy; në vazhdim të procesit të inferenzës dhe kompozimit përftohet një bashkësi fuzzy e daljes që duhet të jetë defuzifikuar. Në sistemin me inferenza të tipit Sugeno përkundrazi mungon procesi i defuzifikimit, duke qenë pasues i rregullave fuzzy si një funksion i variablave të hyrjes. Në modelin e rregullatorit tonë do përdorim sistemin Mamdani për shkak të realizueshmërisë së tij në zbatim.

Procesi i shndërrimit të vlerës së castit (crisp value) në vlerë fuzzy njihet si fuzzifikim, në këtë proces përdorën funksionet e membership. Funksionet e membership përdorën më tej si variabla gjuhësore. Baza e njohurive përmban njohuri për të gjitha ndarjet fuzzy të

funksioneve të hyrjes (input) dhe daljes (output). Baza e rregullave njihet gjithashtu si baza e njohurive. Rregullat e rregullatorit fuzzy janë gjithashtu të disponueshme në bazën e njohurive, të gjitha rregullat e fuzzy janë shkruar duke përdorur njohuritë e mëparshme në lidhje me sistemin. Rregullat e Fuzzy zakonisht shkruhen në formë implikimi, domethënë në formatin NESE-ATËHERË

Më në fund, metoda e shndërrimit të vlerës së fuzzy në vlerë të castit (crisp value) quhet defuzifikim. Në literaturë raportohen shumë lloje të defuzifikimeve, kjo vlerë e pastër e konvertuar përdoret për të kontrolluar sistemin.

### 3.5.2 Avantazhet rregullatorve me logjike Fuzzy

Logjika Fuzzy është funksioni më i përshtatshëm në përafrimin në teorinë e kontrollit. Përparësitë më të rëndësishme të FL janë dhënë më poshtë:

- modelim fleksibël dhe intuitiv i bazës së njohurive.
- saktësia dhe sasia e rezultateve mund të kontrollohen në bazë të njohurive
- modeli konceptual FL mund të përdoret në shumë aplikime të tjera.
- FLC mund të përfshijë një model linear dhe mund të jetë i saktë dhe me jo-linearitetet e sistemit, me fjalë të tjera, FLC jep rezultat të qëndrueshëm edhe me jo-linearitetet.

### 3.5.3 Projektimi i rregullatorit Fuzzy të propozuar për rregullimin fuqi frekuencë

Sinteza e projektimit të rregullatorit FL përfshijë zgjedhjen e funksionit të përshtatshëm të membership, hartimin e saktë të bazës së rregullave dhe metodën e duhur të defuzifikimit. Rregullatori i propozuar sipas logjikës Fuzzy merr të dhëna nga gabimi i zonës ACE dhe shpejtësia e ndryshimit të gabimit të zonës  $d(ACE)/dt$ , sipas të ekuacioni (3.19). Gabimi i zonës është në përpjestim të drejtë me devijimin e frekuencës dhe devijimi i fuqisë së linjës së interkonjeksionit. Pra, nëse ACE zvogelohet atëherë dhe parametrat dinamikë do të zvogelohen.

$$ACE_i = \Delta f_i \cdot B_i + \Delta P_{tie} \quad (3.19)$$

#### 3.5.3.1 Përcaktimi i Funksionit Membership

Funksioni Membership specifikon shkallën në të cilën një madhesi hyrje (input) i caktuar i përket një grupi. Në literaturë përdoren shumë forma të funksioneve të membership nga këta studiues të shumtë sugjerojnë për të përdorur funksionin e membership të tipit trekëndësh. Në Figurën 3.6 jepet funksioni i zgjedhur i membership. Më tej, funksioni i membership është i ndarë në pesë variabla gjuhësore:

Negative Big (NB), Negative Small (NS), Zero (ZO), Positive Small (PS), Positive Big (PB). Dhe funksionet e hyrjeve (Inputët) ACE dhe  $d(ACE)/dt$  kanë të njëjtat pesë variablat gjuhësor siç u tha më lart.




Figura 3.6 Treguesi i Sistemit të Vlerësimit Fuzzy

### 3.5.3.2 Përcaktimi i rregullave Bazë

Rregullat fuzzy janë gjendje të kushtëzuar që specifikon lidhjen midis variablave fuzzy. Me njohuritë e sjelljes së sistemit të hapur po zhvillojme rregullat fuzzy, për shembull, nëse devijimi i frekuencës është më shumë, atëherë nevojitet më shumë përforsim tek rregullatori. Në formatin e rregullave fuzzy do të kemi:

NESE ACE është NB dhe  $d(ACE)/dt$  është NS      ATËHERE      output është PM  
 NESE ACE është PB dhe  $d(ACE)/dt$  është PS      ATËHERE      output është NS

Në mënyrë të ngjashme, zhvillohen të gjitha rregullat fuzzy. Gjithsej janë përcaktuar 49 rregulla fuzzy janë shkruar dhe përfshirë në këtë studim sic tregohen ne. Tabela 3.2 tregon rregullat e kontrollit sipas logjikës fuzzy

Tabela 3.2 Rregullat e rregullatorit Fuzzy

		ACE				
		NB	NS	ZO	PS	PB
$d(ACE)/dt$	NB	PB	PB	PB	PS	PS
	NS	PS	PS	PS	PS	ZO
	ZO	NS	NS	ZO	PS	PS
	PS	ZO	NS	NS	NS	NS
	PB	NS	NB	NB	NB	NB

### 3.5.3.3 Defuzzification

Defuzifikimi është shndërrimi i madhësive fuzzy në një vlerë të vetme (crisp quantity). Dalja e një procesi fuzzy mund të jetë bashkimi logjik i dy ose më shumë funksioneve të membership

fuzzy të përcaktuara në universin e diskursit të variablave të outputi. Në literaturë propozohen shumë metoda të defuzifikimit, por vetëm katër metoda kanë përdorim:

- Metoda membership maksimal
- Metoda mesatare e ponderuar
- Metoda mesatare maksimale e membership dhe
- Metoda Centroid.

Metoda e Membership maksimal ose metoda e lartësisë bazohet në vlerën pik të prodhimit. Metoda mesatare e ponderuar përcaktohet duke peshuar secilin funksion membership në prodhim me vlerën maksimale përkatëse të membership. Metoda maksimale e defuzifikimit funksionon mbi vlerën mesatare të membership në pik. Nga ana tjetër, metoda Centroid, e njohur edhe si qendra e zonës ose metoda e gravitetit është metoda më e përhapur e defuzifikimit. Në këtë punimi është përdorur metoda Centroid për defuzifikim e sinjalit të daljes. Me poshtë jepen tabelat e madhësive të hyrje (input), madhësitë dajes (output) si dhe matrica e rregullave për rregullatorin Fuzzy e propozuar.

**[System]**

Name='fgpi'  
 Type='mamdani'  
 Version=2.0  
 NumInputs=2  
 NumOutputs=1  
 NumRules=25  
 AndMethod='min'  
 OrMethod='max'  
 ImpMethod='min'  
 AggMethod='max'  
 DefuzzMethod='bisector'

**[Output1]**

Name='u'  
 Range=[0 2]  
 NumMFs=5  
 MF1='S':'trimf',[-0.5 0 0.5]  
 MF2='M':'trimf',[0 0.5 1]  
 MF3='B':'trimf',[0.5 1 1.5]  
 MF4='VB':'trimf',[1 1.5 2]  
 MF5='VVB':'trimf',[1.5 2 2.5]

**[Input1]**

Name='E'  
 Range=[-0.001 0.001]  
 NumMFs=5  
 MF1='NB':'trimf',[-0.0015 -0.001 -0.0005002]  
 MF2='NS':'trimf',[-0.001 -0.0005002 0]  
 MF3='ZZ':'trimf',[-0.0005002 0 0.0004998]  
 MF4='PS':'trimf',[0 0.0004998 0.001]  
 MF5='PB':'trimf',[0.0004998 0.001 0.0015]

**[Input2]**

Name='dE'  
 Range=[-0.01 0.02]  
 NumMFs=5  
 MF1='NB':'trimf',[-0.0175 -0.01 -0.0025]  
 MF2='NS':'trimf',[-0.01 -0.0025 0.005]  
 MF3='ZZ':'trimf',[-0.0025 0.005 0.0125]  
 MF4='PS':'trimf',[0.005 0.0125 0.02]  
 MF5='PB':'trimf',[0.0125 0.02 0.0275]

**[Rules]**

1 1, 1 (1) : 1; 1 2, 1 (1) : 1; 1 3, 2 (1) : 1 1 4, 2 (1) : 1 1 5, 3 (1) : 1  
 2 1, 1 (1) : 1 2 2, 2 (1) : 1 2 3, 2 (1) : 1 2 4, 3 (1) : 1 2 5, 4 (1) : 1  
 3 1, 2 (1) : 1 3 2, 2 (1) : 1 3 3, 3 (1) : 1 3 4, 4 (1) : 1 3 5, 4 (1) : 1  
 4 1, 2 (1) : 1 4 2, 3 (1) : 1 4 3, 4 (1) : 1 4 4, 4 (1) : 1 4 5, 5 (1) : 1  
 5 1, 3 (1) : 1 5 2, 4 (1) : 1 5 3, 4 (1) : 1 5 4, 5 (1) : 1 5 5, 5 (1) : 1

## 3.6 Rregullimi frekuencë - fuqi me rregullator Neural

### 3.6.1 Cfarë janë rrjetat neurale?

Një Rrjet Neural Artificial (Artificial Neural Network) është një informacion që përpunon një model që është inspiruar nga sistemet nervore biologjike, të tilla si truri, që përpunon informacionet. Elementi kryesor i këtij modeli është struktura e këtij sistemi të përpunimit të informacionit. Ai përbëhet nga një numër i madh elementësh përpunues të ndërlidhur (neuronet) që punojnë sëbashku për të zgjidhur probleme specifike. ANN-të, ashtu si edhe njërëzit, mësojnë nëpërmjet shembujve. Një ANN konfigurohet për një aplikim specifik, të tillë si klasifikimi i të dhënave, përmes një procesi mësimi. Mësimi në sistemet biologjike përfshin rregullimin në lidhjet sinaptike që ekzistojnë midis neuroneve. Kjo është e vërtetë edhe për ANN-të.

#### 3.6.1.1 Pse të përdorim rrjetat neurale?

Rrjetat neurale, me aftësinë e shquar të tyre për të nxjerrë kuptimin prej të dhënave të komplikuar ose të pasakta, mund të përdoren për të nxjerrë modele dhe të detektojnë trendet që janë shumë komplekse për tu vënë re prej Teknikave të tjera njërëzore apo kompjuterike. Një rrjet neural i përgatitur mund të mendohet si një “ekspert” në kategorinë e informacionit që i është dhënë për tu analizuar. Më vonë ky ekspert mund të përdoret për të siguruar projektimin e situatave të reja dhe t’ju përgjigjet pyetjeve të tipit “po sikur?”. Avantazhet e tjera përfshijnë:

1. *Përshtatshmërinë e mësimi:* Aftësinë e mënyrës së të mësuarit duke u bazuar në të dhënat e dhëna ose në ekspëriencën fillestare
2. *Vetëorganizimi:* Një ANN mund të krijojë organizimin ose përfaqësimin e tij të informacionit që merr gjatë kohës që mëson.
3. *Opërimi në kohë reale:* Llogaritjet ANN mund të bëhen në paralel dhe pasjisje speciale hardware janë duke u projektuar dhe ndërtuar, të cilat do të sigurojnë mundësi më të mëdha.

#### 3.6.1.2 Dobitë e ANN

1. Janë pajisje shumë të fuqishme për llogaritje.
2. Paralelizmat e shumta i bëjnë ato shumë eficientë.
3. Ato mund të mësojnë prej të dhënave të përgatitura - dhe në këtë mënyrë nuk është nevoja për programime të shumta.
4. Ato tolerojnë defektët e veçanta – kjo është ekuivalentë me “degradimin e mirë” që gjendet në sistemet biologjike.
5. Janë shumë tolerantë ndaj zhurmave - në këtë mënyrë mund të përballen me situatë ku sistemet simbolike normale do të kishin vështirësi.
6. Në princip, ato mund të bëjnë gjithçka që bëjnë sistemet simbolike dhe logjike, madje mund të bëjnë edhe më shumë.



### 3.6.1.3 Rrjetat neurale kundrejt kompjuterave tradicional

Rrjetat neurale i zgjidhin problemet ndryshe nga kompjuterat tradicional. Kompjuterat përdorin një përafrim algoritmik. Kompjuteri ndjek disa instruksione të caktuara për të zgjidhur një problem. Nqs nuk njihen hapat që duhet të ndjekë kompjuteri atëherë problemi nuk mund të zgjidhet. Kompjuterat do të ishin shumë herë më të dobishëm nëse do të mund të bënin gjëra që ne nuk dimë se si ti bëjmë. Proçesi i informacionit në rrjetat neurale ndodh në mënyrë të njëjtë si në tru. Rjeti është i përbërë nga një numër i madh neuronesh që punojnë në paralel për të zgjidhur një problem specifik. Rrjetat neurale mësojnë nga shembujt. Ato nuk mund të specifikohen për të bërë një punë specifike. Shembujt duhet të zgjidhen më kujdes sepse në të kundërt kjo do të ishte kohë e humbur ose më keq akoma mundet që rrjeti në funksionojnë në mënyrë të gabuar. Disavantazhi është që nëse rrjeti e gjen vetë mënyrën se si ta zgjidhë problemin, atëherë veprimet e tij mund të jenë të paparashikueshme.

Nga ana tjetër, kompjuterat përdorin një përafrim njohjeje për zgjidhjen e problemit. Mënyra që problemi të zgjidhet është që problemi duhet të jetë i njohur dhe i përcaktuar në mënyrë të qartë. Më pas këto instruksione konvertohen në një nivel gjuhe të lartë programimi dhe më pas në kode makinash që kompjuteri mund ti kuptojë. Këto makina janë totalisht të parashikueshme, nqs diçka shkon gabim për shkak të një defekti në software ose hardware.

Rrjetat neurale dhe kompjuterat nuk janë në garë por plotësojnë njëri-tjetrin. Gjithnjë e më shumë është duke u rritur numri i punëve që kërkojnë që sistemet të jenë një kombinim midis dy përafrimeve (normalisht kompjuterat përdorën për të kontrolluar rrjetat neurale) në mënyrë që të ketë efikasitet maksimal.

Rrjetat neurale nuk bëjnë mrekullira por nqs përdorën saktësisht mund të japin rezultate mahnitëse.

Në vitet e fundit, veçanërisht në dekadën e fundit, pas procesit të derregullimit të tregut të energjisë elektrike, profili i ngarkesës elektrike është bërë jolinear dhe vihen re seri kohë kaotike. Me kalimin e kohës, kërkesa e ngarkesës elektrike është duke u rritur në mënyrë të vazhdueshme sipas një mënyre jo-uniforme. Burimet konvencionale të fuqisë në tokë janë të kufizuara dhe për këtë arsye janë duke u kërkuar mënyra të tjera për të përmbushur kërkesat e ardhshme të ngarkesës elektrike. Këto burime të reja janë quajtur burime jo-konvencionale. Përveç kësaj, burimet konvencionale janë ende në fazë kërkimore kështu që ato mund të punojnë në mënyrë optimale me kërkesën maksimale të fuqisë. Vrojtimi i literaturave [8,9,10] tregon që rrjetat neurale kanë gjetur përdorim të gjerë dhe në problemin e rregullimit frekuencë-fuqi.

## 3.6.2 Analiza rregullatorit frekuencë-fuqi dhe sistemit të rregullimit

### 3.6.2.1 Struktura e rrjetave neurale

Një layer i shumëfishtë feed-forward neural network (FNN) është përdorur për qëllimet e STLF. FNN është trajnuar që të përafrojë funksionet jonlineare  $F_s(.)$  midis ndryshimit frekuencës dhe variablave hyrës. FNN përmban një layer me njësitë e hyrjeve, një layer tjetër të fshehur dhe variablat e hyrjes. Një FNN me një layer të fshehur është secila hyrje  $ith$  e lidhur me secilën njësi  $jth$  të layer-it të fshehur me një faktor rëndese (weighting factor),  $W_{ij}$ . Secila

njësi në layer-in e fshehur, e quajtur neuron, përformon një transformim jolinear të sinjaleve hyrës të rëndesës. Modeli i njësisë  $j$  (neuroni  $j$ ) në layer-in e fshehur tregohet në Figurën 3.7. Dalja e këtij neuroni mund të formulohet si:

$$A_j = f_h(\text{net}_j) \quad (3.20)$$

Ku:  $f_h$  është një funksion i aktivizimit jolinear në layer-in e fshehur, dhe  $\text{net}_j$  mund të formulohet në këtë mënyrë:

$$\text{net}_j = \sum_{i=1}^{N_i} W_{ij} * x_i + b_j \quad (3.21)$$

Ku:  $x_i$ : është inputi i njësisë  $i$  në layer-in hyrës;  
 $W_{ij}$ : është faktori i rëndesës midis neuronit  $i$  të layer-it hyrës dhe neuronit  $j$  të layer-it të fshehur;  
 $b_j$ : është faktori që ndikon të neuroni (term konstant).

Të gjithë faktorët e rëndesës dhe tërmat ndikues rregullohen gjatë procesit të trajnimit.




Figura 3.7. Një FFNN me një layer të fshehur

Funksioni aktivizues  $f_h$  mund të jetë një funksion monotonic (bounded monotonic function) i tillë si tangjentja hipërbolike, sigmoid, signum, semi-linear, etj dhe në procesin trajnues ndryshohet vetëm vlera e pjerrësisë (shiko figurën 3.8).

Struktura e një layer-i FNN dalës është e njëjtë me atë të layer-it të fshehur me përjashtimin që hyrjet e layer-it dalës janë daljet e layer-it të fshehur. Dalja e neuronit “ $k$ ” në layer-in dalës mund të formulohet si:

$$y_k = f_n(\text{net}_k) \quad (3.22)$$

ku:  $f_n$ : është funksioni jolinear i aktivizimit në layer-in dalës,  
 $\text{net}_k$ : është e barabartë me:

$$\text{net}_k = \sum_{j=1}^{N_h} W_{jk} * A_j + b_k \quad (3.23)$$

dhe  $W_{jk}$  është faktori i rëndesës midis neuronit  $j$  në layer-in e fshehur dhe neuronit  $k$  në layer-in dalës.

### 3.6.2.2 Arkitekura e rrjetës neurale

Numri i hyrjeve, layer-ave të fshehur, neuroneve në layer-at e fshehur dhe daljet zakonisht përcaktojnë arkitekturën e FNN. Në këtë model, janë përdorur 4 FNN të pavarur për të përcaktuar ndryshimin e frekuencës në zonen e zgjedhur. Secili rrjet është përdorur për të përcaktuar funksionin e daljes së rregullatorit neural. Janë relizuar 4 FNN në MetrixND, një paketë e rrjetave neural. Këto inputë dhe arkitektura e layerave të fshehur dhe atyre dalës janë shpjeguar më poshtë.




Figura 3.8. Modeli i neuronit jolinear në layer-in e fshehur

Variablat e hyrjes si frekuenca, fuqia e gjenreua, fuqia në linjë dhe ndryshimi i ngarkes të cilat ndryshojnë kanë një ndikim të rëndësishëm në funksionin e daljes të rregullatorit. Variabli dalës i FNN është funksioni i rregullimit të secilës zone. Në këtë material është marrë në shqyrtim modeli Narma L i strukturës së rrjetës neurale të cilën e ofron Simulinku kjo strukturë është zgjedhur për shkak të performancës së tij lartë.

### 3.6.2.3 Vlerësimi i performancës së rregullimit

Një hap i rëndësishëm në procedurën e ndërtimit të rrjetit neural është vlerësimi i performancës së rregullimit. Në përgjithësi, indeksi i performancës është një matje e gabimit të rezultit të pritshëm të një seti të pavarur të dhënash. Gabimi i rezultit të pritshëm duhet të jetë i pranueshëm nëse rrjeti neural është ndërtuar në mënyrë të saktë dhe në qoftë se të dhënat përfaqësojnë plotësojnë kërkesat e cilësive të dëshiruara. Zgjedhja e treguesve të përshtatshëm të performancës do të trajtohet më poshtë.

#### 3.6.2.3.1 Treguesit e performancës

Janë propozuar shumë mënyra që shërbejnë si tregues performancë për saktësinë e rezultit. Në këtë shembull, dy mënyrat më të përdorshme për vlerësimin e rezultit janë: 1) varianca,  $\sigma^2$ ; dhe 2) përqindja e vlerës mesatare të gabimit (MAPE-mean absolute percentage error), e cila mund të formulohet si më poshtë:

$$\sigma^2 = \frac{1}{N} \sum_{n=1}^N (L_F^n - L_A^n)^2 \quad (3.24)$$

ku  $L_F$  është rezultati i rrjetës,  $L_A$  është rezultati i deshiruar,  $n$  është numri i të dhënave (data point) në setin e të dhënave dhe  $N$  është numri total i të dhënave. Përqindja e vlerës mesatare të gabimit  $\varepsilon$  mund të formulohet:

$$\varepsilon = \frac{1}{N} \sum_{n=1}^N \frac{|L_F^n - L_A^n|}{L_A^n} * 100 \quad (3.25)$$

Në shembullin e lartpërmendur rrjeti neural u trajnuar me të dhënat e marra nga Rezultatet e rregullatorit PID.

### 3.7 Sinteza e rregullatorit neural NARMA-L2

Rregullatori i neural i përdorur në këtë tëmë njihet me dy emra: Feedback linearization control ose NARMA-L2 control. Funkzioni që kryen ky rregullator është transformimi i një sistemi me dinamikë jolineare në një sistem me dinamikë lineare ose ndryshe në një sistem të qëndrueshëm. (Narendra and Mukopadhyay, 1997). Një model NARMA përshkruan saktësisht një sistem të paqëndrueshëm në rrjetin e madh të sistemeve të nderidhura. Egzistojnë dy tipe të rregullatorësh NARMA që njihen si NARMA-L1 dhe NARMA-L2. E veçanta e këtyre rregullatorëve është fakti që variabli i inputit të rregullatorit  $u(k)$  në kohën  $k$  shfaqet linearisht në ekuacionet që lidhin variablin e inputit dhe outputit. Kjo bën të mundur llogaritje më të thjeshtë algjebrike dhe përdorimin vetëm të metodave me gradientë statikë. Ekuacionet e propozuara të dy modeleve të NARMA-L2 janë paraqitur më poshtë:

Modeli NARMA-L1:

$$y(k+d) = f_0[y(k), y(k-1), \dots, y(k-n+1)] + \sum_{i=0}^{n-1} y_i[y(k), y(k-1), \dots, y(k-n+1)]u(k-i) \quad (3.26)$$

Modeli NARMA-L2:

$$y(k+d) = f_0[y(k), y(k-1), \dots, y(k-n+1), u(k-1), \dots, u(k-n+1)] + g_0[y(k), y(k-1), \dots, y(k-n+1), u(k-1), \dots, u(k-n+1)]u(k) \quad (3.27)$$

Avantazhi i modelit të ekuacionit të NARMA-L2 është se mund të zgjidhet për variabla të hyrjes që bëjnë që variablat e daljes së sistemit të ndjekin referencën  $y(k+d) = y_r(k+d)$ . Rezultati i kontrollerit do të diletë në formën:

$$y(k) = \frac{y_r(k+d) - f[y(k), y(k-1), \dots, y(k-n+1), u(k-1), \dots, u(k-n+1)]}{g[y(k), y(k-1), \dots, y(k-n+1), u(k-1), \dots, u(k-n+1)]} \quad (3.28)$$

Në figurën 3.9 është paraqitur rregullatori NARMA-L2 i cili është përdorur në linearizimin e sistemit të fuqisë me 4 zona dhe në Figurën 3.10 identifikimi i modelit për sistemin e fuqisë.




Figura 3.9. Rregullatori NARMA L2 i përdorur në rregullimin frekuencë-fuqi në sistemin me 4 zona.

Duke përdorur të dhënat e rregullatorit PID për trajnim të rrjetës neurale. Pas një serie modifikimesh dhe gabimesh, arkitektura e ANN e cila mundëson performancën më të mirë duke përdorur rregullatorin NARMA-L2. Ne Tabelen 3.3 janë paraqitur karektëristikat e rregullatorit NARMA – L2 dhe të dhënat optimale të sistemit të fuqisë me katër zona.

Tabela 3.3: Karakteristikat e rregullatorit neural

Nr	Përshkrimi	Sasia
1	Numri i shtresave	9
2	Numri i neuroneve në shtresën e fshehur	13
3	Inputët	3
4	Outputët	2

Tabela 3.4: Karakteristikat e sistemit me regullator neural

Nr	Përshkrimi	Sasia
1	Numri i shtresave	3
2	Numri i neuroneve në shtresën e fshehur	10
3	Inputët	4
4	Outputët	1
5	Funksioni i aktivizimit	trainlm function
6	Shembujt e trajnimit	10000
7	Numri i provave	100





Figura 3.10. Rregullatori NARMA Identifikimi i modelit

### 3.7.1 Trajnimi i gabimit të rregullatorit NARMA L2

Gjatë simulimit të rregullatorit NARMA L2, të dhënat e trajnimit input/output të sistemit dhe neurokontrollerit gjithashtu dhe gabimet e sistemit dhe modelit të kontrollerit janë dhënë në figurën 3.11 më poshtë.






Figura 3.11. Grafikët e të dhënave të gabimeve gjatë trajnimit të sistemit

### 3.7.2 Vlerësimi i të dhënave të trajnimit

Algoritmi i trajnimit jepet si më poshtë në figurën 3.12 dhe specifikon funksionin e aktivizimit trainlm (Levenberg-Marquardt). Performanca është vlerësuar nga vlera mesatarje e gabimit kuadratik dhe të dhënat e divizionit janë të specifikuara si (divideind). Trajnimi i rregullatorit NARMA L2 u zhvillua në sistemin parësor të fuqisë për katër zonat.




Figura 3.12. Vlerësimi i të dhënave të trajnimit dhe i përfomancës.

# KAPITULLI IV

---

## SIMULIMET E SISTEMIT TË FUQISË ME KATËR ZONA DHE ANALIZA E REZULTATEVE

### 4.1 Hyrje

Në këtë kapitull do të trajtohen simulimet e modelit të sistemit të fuqisë me katër zona të ndërlidhura duke përdorur rregullatorë të ndryshëm. Pasi është ndertuar modeli i sistemit dhe janë përzgjedhur parametrat e rregullatorit dytësor. Të tre modelet janë ndërtuar dhe simuluar në platformën Simulink të programit Matlab. Simulimet janë kryer për tre rastë:

- a. kur në sistem kemi rregullator dytësor të tipit PID,
- b. kur në sistem është vendosur rregullatori dytësor sipas logjikës Fuzzy
- c. dhe rasti kur kemi rregullatorë sipas logjikës së rrjetave neuralë (ANN).

Për secilën zonë është marrë një ngacmim me vlerë relative 0.02 nj.r.b ose 40 MW në vlerë absolute. Nga analiza e simulimeve për çdo model, zonë apo rast janë përcaktuar dhe vlerësuar treguesit e cilësisë së përgjigjes kalimtare sipas kritereve të përcaktuar në Kapitullin 3. Si parametra që do të vlerësohen janë koha e stabilizimit së funksionit të ndryshimit të frekuencës dhe fuqisë aktive të linjës së interkonjeksionit, vlera e devijimit maksimal të ndryshimit të frekuencës dhe fuqisë në linja si edhe vlera e gabimit statik. Këto vlera janë krahasuar për modelet, zonat dhe rastet përkatëse për të vlerësuar performancë e secilit rregullator në rregullimin frekuencë-fuqi të sistemit.

Në modelin tonë të rregullimit frekuencë-fuqi që kemi marrë në analizë, ekzistojnë tri lloje turbinash të përgjithshme: Zona 4 (Shqipëria) me njësi turbinë hidraulike Zona 2 (Kosova) dhe Zona 1 ( Mali i Zi) me njësi turbinë pa tëjnxehje, Zona 3 (Greqia) me njësi turbinë me tëjnxehje dhe, të cilat modelohen nga funksionet e transmetuese përkatëse për secilën prej tyre. Më poshtë është paraqitur tabela e parametrave nominalë të sistemit të fuqisë që nevojitet për të ndërtuar dhe simuluar sistemin e fuqisë në platformën Simulink të softit Matlab. Në tabelën 4 jepen të dhënat nominale të sistemit të fuqisë të marrë në studim.



Tabela 4.1. Të dhënat sistemit të fuqisë

